



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Siguri
Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”**

ofruar nga

Akademia e Forcave të Armatosura

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Elson Agastra

Prof. Asoc. Dr Enri Hide

Elson Agastra

Enri Hide

Nëntor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” ofruar nga “Akademia e Forcave të Armatosura”

1	IAL aplikues:	Akademia e Forcave të Armatosura
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR, Nr. 375, datë 23.09.2021.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Nr.156, datë 19.02.2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 178, datë 10.07.2024
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	NA
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	NA
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	NA
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	NA
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 0 PAE / 7 PAK 2022-2023 3 PAE / 7 PAK 2023-2024 4 PAE / 8 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 15 studentë 2022-2023 19 studentë 2023-2024 23 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Akademia e Forcave të Armatosura, është licencuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 28.10.1961 dhe ka marrë statusin e veçantë me VKM nr. 156, datë 19.02.2020 si Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) i vetëm në vend në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Akademia e Forcave të Armatosura, me njësitë kryesore të saj është akredituar institucionalisht në 04.04.2025 me vendimin nr. 63, të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite.

Programi i studimit i ciklit të dytë, Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, organizohet në IAL Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, njësi kryesore e përbërë nga njësitë bazë si në vijim:

1. Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë (FMS)
 - i. Departamenti i Shkencave Ushtarake
 - ii. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave të Komunikimit
 - iii. Departamenti i Teknologjise se Informacioni
 - iv. Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë është njësia kryesore e cila ofron programin e studimit Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Njësia bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Teknologjisë së Informacionit**. Kjo njësi bazë, së bashku me njësi të tjera akademike si dhe strukturave ndihmës akademike, administrative, japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit.

Programi i studimit Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL” dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Ky program studimi zhvillohet në një vit akademik me 60 kredite ECTS.

Raporti i paraqitur në këtë dokument, si më poshtë vijon, është një vlerësim në kuadër të akreditimit për herë të parë të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr.109, datë 15.05.2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes".

Bazuar në Urdhrin nr. 124, datë 10.10.2023 "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Akademia e Forcave të Armatosura, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

- 1. Prof. Dr. Elson Agastra**
- 2. Prof. Asoc. Enri Hide**

Gjatë procedurës GJV është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Z. Arbri Ndreka.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Janar 2025 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Akademia e Forcave të Armatosura, po ashtu, vuri në dispozicion të GJV një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GJV u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Gjatë vizitës së kryer në AFA, në datat 5 dhe 6 Shkurt 2025, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Akademisë së Forcave të Armatosura. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GJV hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GJV u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GJV vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e studimit dhe të kompjuterave, bibliotekën, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GJV-së sipas kërkesave.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit

IAL është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.11.2025, pëmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.29/27 Prot, datë 03.11.2025. IAL njofton në ASCAL më datë 10.11.2025, “Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin që nuk kanë komente. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë që ka një status të posaçëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Ajo vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e saj me të njëjtin status ligjor, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 21.09.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.02.2020. Ky vendim përcakton njohjen zyrtare të AFA-së si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë që operon në këtë fushë specifike, duke rregulluar njëkohësisht organizimin dhe funksionimin e saj. Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është licencuar me Urdhër Nr. 419, datë 16.07.2018, të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Zbatimi i programit dhe funksionimi i AFA-së mbështeten në Rregulloren e Akademisë, rregulloren e njësisë kryesore, si dhe rregulloren e programit të studimit, të gjitha në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore që burojnë prej tij. Ev-2-Rregullore e brendshme e AFA Ev-5-Rregullore e Fakultetit Mbrojtjes dhe Sigurisë Ev-6-Rregullore e Programit të Studimit
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është konceptuar në përputhje të plotë me politikat zhvillimore të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), duke synuar përgatitjen e specialistëve të kualifikuar në fushën e sigurisë kibernetike.

	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS), në harmoni me misionin, vizionin dhe drejtimet strategjike të institucionit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, ka projektuar dhe zhvilluar këtë program për t'iu përgjigjur nevojave në rritje të institucioneve të mbrojtjes për ekspertë në sigurinë kibernetike dhe menaxhimin e informacionit. Ky program është plotësisht në përputhje me objektivat strategjike të AFA-së dhe mbështet misionin e saj institucional, të përcaktuar në Statutin zyrtar të Akademisë. Në përputhje me këtë mision, AFA synon krijimin, zhvillimin dhe transmetimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentët, duke i pajisur ata me përgatitjen e nevojshme për t'u afirmuar si profesionistë të denjë në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit. AN-4.4-Misioni dhe qëllimi i programit MPCs AN-4.4.1-Studimi i tregut të punës MPCs AN-4.5-Strategjia e zhvillimit të programit MPCs
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i studimit është konceptuar dhe implementuar në harmoni me strategjinë e zhvillimit të Akademisë së Forcave të Armatosura. Ai reflekton objektivat kryesore strategjike të institucionit, duke përfshirë diversifikimin e ofertës arsimore, përshtatjen e metodave pedagogjike dhe mekanizmave të financimit, si dhe zgjerimin horizontal të sistemit arsimor. Të gjitha këto janë në përputhje me kërkesat për zhvillim afatgjatë të vendit dhe përbëjnë një element thelbësor të planit strategjik të AFA për realizimin e misionit të saj institucional. Si rrjedhojë, në përputhje me këtë projektim të IAL-së, ky program studimi zgjeron pikërisht gamën e ofertës së institucionit në tregun e arsimit të lartë duke u përshtatur me nevojat e tregut të punës për fushat e specialitetit. Dokumentet themelore të institucionit përcaktojnë qartë drejtimet kryesore akademike që përbëjnë prioritet për AFA. Në to theksohet angazhimi i institucionit për të konsoliduar programet ekzistuese dhe për të siguruar që çdo iniciativë për hapjen e programeve apo cikleve të reja studimore të jetë në përputhje me standardet dhe kriteret e nevojshme. Programi i ciklit të dytë "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" përbën një shembull konkret të këtij angazhimi, pasi lidhet ngushtësisht me prioritetet akademike të AFA, me objektivat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, si edhe me kërkesat aktuale të tregut të punës. Ev-7-Planit Strategjik i Zhvillimit të AFA AN-4.4-Misioni dhe qëllimi i programit MPCs

	AN-4.4.1-Studimi i tregut të punës MPCs AN-4.5-Strategjia e zhvillimit të programit MPCs			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesat në ritje të tregut të punës për profesionistë të kualifikuar në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, me fokus të veçantë në sigurinë kibernetike dhe menaxhimin e informacionit. Në përputhje me politikat kombëtare që synojnë integrimin e Republikës së Shqipërisë në strukturat ndërkombëtare evropiane dhe përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, ky program synon të formojë specialistë me aftësi të avancuara dhe kompetenca të thelluara në këtë degë strategjike të TIK-ut, të përgatitur për të përballuar sfidat moderne të sigurisë dhe inovacionit. Ev-7-Planit Strategjik i Zhvillimit të AFA Ev-8-Studimi për tregun e punës për programin e studimit			
Konkluzione	<i>Institucioni ofron programin e studimit në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si institucion i vetëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ky program synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare në fushën e sigurisë kibernetike dhe në përputhje me direktivat e NATO-s.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Cilësia dhe eksperiencia e stafit akademik, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, së bashku me përvojën e gjatë të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) si institucioni i vetëm i arsimit të lartë në vend në fushën e mbrojtjes, përbëjnë një tregues të qartë të kapaciteteve profesionale dhe institucionale në ofrimin e programit të Masterit Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Gjatë vitit akademik 2023–2024, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) përbëhej nga 52 anëtarë të personelit akademik të brendshëm (PAE), prej të cilëve 18 mbajnë grada dhe tituj shkencorë. Ndërkohë, personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga 9

	pedagogë të jashtëm, ndër të cilët 3 zotërojnë grada dhe tituj akademikë. Në programin e studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, për të njëjtin vit akademik, janë angazhuar 9 anëtarë të stafit akademik, mes të cilëve 1 Profesor i Asociuar dhe 2 me gradë shkencore “Dr./PhD”. Këta ekspertë kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe aktiviteteve praktike, duke sjellë një përvojë të pasur akademike dhe profesionale në fushën e sigurisë kibernetike. Një komponent i rëndësishëm i stafit janë gjithashtu ekspertët e Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike (NJUSK), që operojnë në kuadër të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, duke e bërë programin unik në aspektin e integritetit të ekspertizës ushtarake dhe civile në fushën e sigurisë digjitale dhe mbrojtjes kombëtare. Edhe pse personeli i angazhuar nga kjo njësi, është me eksperiencë në fushën e programit të studimit, ka vetëm kualifikimin në nivel Master i Shkencave. Ev-9-Tabelë me të dhënat përmbledhëse Ev-10-Programi Mësimor MP “Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Drejtimit kërkimore shkencore të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) për periudhën 2020–2025, që lidhen drejtpërdrejt me ciklin e studimit të Masterit Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, të zhvilluar pranë Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS), janë përqendruar në dy fusha kryesore: • Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit • Siguria Kibernetike dhe e Informacionit Nga analiza e dokumenteve strategjike të institucionit, konstatohet përputhje e plotë midis fushës specifike të programit të studimit dhe drejtimeve akademike–kërkimore të njësisë kryesore. Kjo tregon se programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të reflektojë prioritetet kërkimore dhe zhvillimore të AFA-së, duke garantuar koherencë të plotë midis objektivave akademike, kërkimit shkencor dhe nevojave të sektorit të mbrojtjes.

	Gjithashtu, përputhshmëria në fushën e gjerë të teknologjisë së informacionit dhe sigurisë është e dukshme në të gjithë programet e ofruara nga FMS, duke forcuar rolin e tij si një njësi akademike që ndërthur inovacionin teknologjik, kërkimin shkencor dhe përgatitjen profesionale në mbështetje të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes kibernetike. Ev-11-Planifikimi për Kërkimin Shkencor 2023-2024 Ev-12-Të dhënat tabelore për numrin e programeve
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i Masterit Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” bën pjesë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Ekziston një harmoni e plotë ndërmjet fushës së përgjithshme dhe asaj të specializuar të programit me profilin akademik dhe shkencor të njësisë bazë përgjegjëse. Kjo përputhje është e dukshme jo vetëm në këtë program konkret, por edhe në të gjitha programet e tjera të zhvilluara nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, duke reflektuar koherencë të vazhdueshme ndërmjet objektivave akademike dhe kërkimit shkencor. Ev-12-Të dhënat tabelore për numrin e programeve
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Institucioni nuk ofron programe jashtë profilit të institucionit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	AFA zhvillon në mënyrë të vazhdueshme trajnime profesionale dhe aktivitete të avancuara për studentët aktualë dhe të diplomuar, në bashkëpunim me institucionet e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe me aktorë të tjerë publikë dhe privatë. Një shembull domethënës është trajnimi me temë “Kriptografia”, i realizuar më 4, 5 dhe 6 qershor 2024, në bashkëpunim me ekspertët e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, AFA dhe Reiffeisen Bank. Ky trajnim kishte për qëllim zhvillimin e kapaciteteve teknike të studentëve dhe të diplomuarve në fushën e sigurisë kibernetike, duke u ofruar njohuri të avancuara teorike dhe praktike. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën me procesin e menaxhimit të incidenteve kibernetike dhe morën pjesë në një ushtrim praktik

	(Cyber Drill Exercise) që simulonte situata reale të ndërhyrjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike.			
	Ev-13-Eventi Hackathone me Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes			
Konkluzione	<i>Programi është në përputhje me fushën akademik që Institucioni ka si dhe njësia kryesore "Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë". Duke qënë se AFA ofron programin e ciklit të parë në Teknologji Informacioni në fushën e mbrojtjes edhe prgrami i ciklit të dytë është në të njëjtin vazhdim të cikleve studimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me hartimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në rregulloren e brendshme të AFA, si dhe në rregulloren përkatëse të njësisë kryesore. Këto përgjegjësi ndahen ndërmjet strukturave të ndryshme institucionale, por rolin kryesor e mban njësia bazë përgjegjëse për programin. Brenda këtij kuadri rregullator, është përcaktuar në mënyrë të detajuar roli i drejtuesit të njësisë bazë dhe kontributi i stafit akademik në proceset që lidhen me planifikimin, zbatimin dhe zhvillimin cilësor të programit. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Dekani, përgjegjësi i departamentit, dekanati dhe strukturat administrative të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Akademisë, si dhe me aktet rregullative të posaçme që udhëheqin veprimtarinë institucionale. Këto dokumente përfshijnë strategjinë institucionale, planet vjetore të veprimtarisë akademike dhe financiare, si edhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të vendimeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Vërehet se këto struktura kryejnë një mbikëqyrje të rregullt dhe funksionale të veprimtarisë akademike së stafit, duke siguruar

	respektimin e standardeve institucionale dhe të objektivave të përcaktuara. Në përfundim të çdo viti akademik, Departamenti përkatës zhvillon Analizën Vjetore, e cila paraqet një proces të qëndrueshëm vlerësimi dhe reflektimi mbi realizimin e objektivave formues dhe arritjen e rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit profesional për programin e Masterit Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Në këtë analizë, identifikohen qartë pikat e forta dhe aspektet që kërkojnë përmirësim, si dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm apo sfidat që ndikojnë në zbatimin e programit. Ky proces kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe në forcimin e mekanizmave të menaxhimit akademik dhe institucional. Ev-2-Rregullore e brendshme e AFA Ev-14-Raport mbi veprimtarinë akademike dhe kërkimore shkencore të personelit akademik efektiv të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ka zhvilluar një bashkëpunim të gjerë ndërinstitucional në funksion të realizimit të objektivave akademike dhe formuese të programit të studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Ky bashkëpunim është konkretizuar me një sërë institucioneve arsimore dhe organizatash partnere, përfshirë: • Universitetin Politeknik të Tiranës • Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës • Universitetin “Luarasi” • Universitetin “Fan Noli” Korçë • Universitetin “Marin Barleti” • Akademinë e Sigurisë • Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes • Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (AKSK) Vërehet se këto partneritete kanë qenë thelbësore që në fazën e hartimit të programit, duke filluar nga studimi i tregut të punës dhe analiza e nevojave profesionale deri te përgatitja e planit mësimor dhe strukturës së programit.

	Këto bashkëpunime janë zyrtarizuar përmes marrëveshjeve institucionale të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Akademisë së Forcave të Armatosura, duke garantuar një bazë ligjore dhe institucionale të qëndrueshme për zhvillimin e programit dhe përfshirjen e ekspertizës kombëtare në fushën e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes kombëtare. AN-4.22-Politika të bashkëpunimit AN-4.22.1-Marrëveshje Bashkëpunimi Ev-15-Institucionet bashkëpunuese me AFA
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi institucional me qëllim sigurimin e praktikave profesionale cilësore për studentët e programit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë aktorësh strategjikë në fushën e sigurisë kibernetike, mbrojtjes dhe teknologjisë së informacionit, përfshirë: • Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike (NJUSK) • Agjencinë e Informacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes • Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes • Strukturat ushtarake nën varësinë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura • Banka të nivelit të dytë • Qendra trajnimi profesionale si p.sh. Cyber Morfosis dhe Albanian ICT • Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (AKSK) • Strukturat civile në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes Këto partneritete i mundësojnë studentëve përfshirje aktive në mjedise reale të punës, duke u ekspozuar ndaj sfidave dhe praktikave bashkëkohore të mbrojtjes kibernetike. Gjithashtu, angazhimi i Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHPPFA) në kuadër të thirrjeve për trajnime nga NATO dhe programeve për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, veçanërisht në fushën e teknologjisë së informacionit, dëshmon për koordinimin efektiv midis arsimit, kërkimit dhe praktikës profesionale.

	Ky bashkëpunim ndihmon në rritjen e cilësisë së përgatitjes profesionale të studentëve dhe në forcimin e kompetencave institucionale të AFA-së në fushën strategjike të sigurisë kibernetike. Ev-72-Thirrje trajnime dhe rritje kapacitetesh burime njerëzore AFA/MM/NJUSK nga NATO AN-4.22-Politika të bashkëpunimit AN-4.22.1-Marrëveshje Bashkëpunimi Ev-15-Institucionet bashkëpunuese me AFA			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm vëren se njësia përgjegjëse për programin e studimit zhvillon raporte periodike monitorimi dhe vlerësimi, me qëllim sigurimin e një pasqyre të plotë dhe të vazhdueshme mbi rezultatet dhe përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura në kuadër të zbatimit të programit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes.” Këto raporte shërbejnë si instrument efektiv i menaxhimit dhe përmirësimit të cilësisë, duke mundësuar analizimin e efektivitetit të bashkëpunimeve ndër-institucionale, vlerësimin e kontributit të partnerëve akademikë dhe institucionalë në procesin mësimor, si dhe identifikimin e mundësive për thellim dhe zgjerim të mëtejshëm të bashkëpunimit në funksion të përmbushjes së objektivave të programit.			
Konkluzione	<i>Institucioni tregon se ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare apo ndërkombëtare por ky portofol duhet të jetë më i gjerë, i larmishëm dhe konkret për programin e studimit. Mobiliteti dhe kërkimi shkencor ngelet një pikë jo e fortë dhe kërkon bashkëpunim me aktorë vendas ose te huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se institucioni e ofron programin e studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i organizuar në lëndë (module), secila prej të cilave është e vlerësuar me kredite ECTS, në përputhje me standardet e përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Totali i krediteve për ciklin e dytë të studimeve është 60 ECTS, të cilat realizohen brenda një periudhe njëvjeçare (2 semestra), që përbën kohëzgjatjen normale të programit. Lëndët dhe aktivitetet formuese janë grupuar në pesë kategori (A–E) sipas përcaktimeve ligjore: • Lëndë bazë, që sigurojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën profesionale. • Lëndë karakterizuese, të cilat lidhen drejtpërdrejt me veçoritë e programit dhe sigurojnë formim specifik në fushën e sigurisë kibernetike. • Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese, që bashkojnë koncepte nga fusha të ngjashme dhe ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave të përbashkëta profesionale. Lëndë me zgjedhje, që i japin studentit mundësinë të thellojë njohuritë në fusha të caktuara të interesit profesional. Lëndë plotësuese, të fokusuara në përvetësimin e aftësive gjuhësore, informatike, komunikuese dhe prezantuese, si dhe në përgatitjen për tezën e diplomës ose provimin përfundimtar. Struktura e programit dhe shpërndarja e krediteve dëshmojnë për një projektim koherent dhe të balancuar akademik, që garanton arritjen e rezultateve të të nxënësve në përputhje me objektivat e formimit profesional dhe kërkesat e tregut të punës në fushën e sigurisë kibernetike. Ev-10-Programi Mësimor i Masterit Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”

	Ev-17-Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive formuese të programit
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	AFA përcakton programe prioritare studimi në përputhje me misionin, vizionin dhe kushtet infrastrukturore si dhe në përputhje me direktivat e MM dhe SHPPFM Objektivi kryesor i Programit të Ciklit të Dytë të Studimit, Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë (si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative) në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit. Zhvillimin tek studentët të njohurive e aftësive të gjera e të thelluara profesionale, për vlerësim kritik dhe mendim analitik të pavarur, aftësi për të zgjidhur probleme komplekse dhe për t’u rritur në karrierën profesionale. Ndër qëllimet kryesore të programit është formimi i gjeneratës së re të profesionistëve, të cilët do të kenë njohuritë e duhura dhe kompetencat për të zhvilluar sisteme më të sigurt kompjuterike. Programi i studimit është i lidhur ngushtësisht me nevojat e tregut të punës dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit. Arritjet e deri tanishme janë rezultat i dinamikës dhe strategjisë së zhvillimit të institucionit, e cila mbështetet në filozofinë e përgatitjes së specialistëve të rinj profesionistë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Sigurisë Kibernetike me njohuri, aftësi dhe kompetenca bashkëkohore. Duke u bazuar në kurrikulën e përzgjedhur, studentët kanë mundësi të zgjedhin midis një game të gjerë specialitetesh si p.sh.: • Oficer i Sigurisë së Sistemeve të Informacionit; • Administrator Bazash të Dhënash të Sigurta; • Analist i sigurisë së Informacionit ose Information Security Analyst • Testues i depërtimit ose Penetration tester etj. • Konsulent i Sigurisë së Informacionit • Menaxher i Sigurisë së Informacionit • Menaxher Projektsh në fushën e Sigurisë së Informacionit Ev-6-Rregullore e Programit të Studimit Ev-7-Plani Strategjik i Zhvillimit të AFA Ev-15-Institucionet bashkëpunuese me AFA.

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” parashikon në strukturën e tij një komponent të detyrueshëm të praktikës profesionale, e cila vlerësohet me 8 kredite ECTS, në përputhje me standardet e përcaktuara në programin mësimor dhe aktet ligjore në fuqi. Sipas planit të studimit, praktika profesionale përfshin gjithsej 150 orë pune, të ndara si më poshtë: • 60 orë në auditor (15 javë × 4 orë), të dedikuara për udhëzime teorike, seminare dhe takime me pedagogun udhëheqës; • 90 orë pune praktike, të realizuara përgjatë 10 javëve (9 orë/javë) në një institucion, organizatë, kompani, ose përmes punës individuale të studentit, që përfshin takime këshilluese dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të praktikës. Grupi vëren se procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale janë të formalizuara përmes akteve të brendshme rregullative të Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë: • hapat dhe afatet që duhet të ndiqen nga studentët dhe personeli akademik; • detyrimet dhe përgjegjësitë e njësive përkatëse; • rolet e aktorëve të përfshirë në procesin e planifikimit, ndjekjes dhe vlerësimit të praktikës profesionale. Këto mekanizma sigurojnë që procesi i praktikës të jetë i strukturuar, transparent dhe i orientuar drejt përfitimeve reale mësimore dhe profesionale për studentët e programit. Në syllabuset e lëndëve nuk paraqitet mënyra e vlerësimit dhe as ekuivalentimi i tyre në notën përfundimtare. Vlerësimi i dijeve, paraqitet si në rregulloren e programit të studimit, ashtu edhe në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies. Këto dy rregullore për sa i përket këtij kriteri janë në sinkron mes tyre. Megjithatë, paraqesin një mospërputhje në sistemin e
--	---

vlerësimit, si në vlerësimin me pikë, ashtu edhe në shprehjen e tyre në nota, qoftë në nota me bazë 10, ashtu edhe në vlerësim me gërma sipas sistemit anglo-sakson. Më konkretisht, neni 22, “Sistemi i Vlerësimit” në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies nuk është në përputhje me nenin 6, “Forma e studimit, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti”, të rregullores së programit të studimit.

Mënyra e vlerësimit në pikë, gërma dhe notë, është në përputhje mes Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies si dhe suplementit të diplomës.

Krahasimi mes këtyre dy formave paraqitet në tabelën në vijim:

Rr. Zhvillim Kurrikular Si dhe Suplmenti i diplomës			Rr. Program studimi		
Pikë	Notë	Shkronjë	Pikë	Notë	Shkronjë
96-100	10	A+	94-100	10	A
86-95	9	A	85-93	9	A-
76-85	8	B+	76-84	8	B
66-75	7	B	67-75	7	B-
56-65	6	C+	58-66	6	C
46-55	5	C	51-57	5	D
≤45	4	M	≤50	4	F
Nuk ka realizuar kredite të lëndës		P	-	-	-

Nga ku dukshëm këto dy sisteme vlerësimi nuk janë në sinkron mes tyre, si në vlerësimin me bazë 100 (pikë), ashtu edhe në ekuivalentimin e tyre me gërmë.

Ky informacion, për studentët e diplomuar, të cilët janë të pajisur me suplementin e diplomës, mund të mos jetë burim ngatërrese në rast transferimi studimesh, por për studentët që nuk janë diplomuar, dhe duan të realizojnë transferimin e studimeve nga AFA drejt një institucioni tjetër të arsimit të lartë që përdor sistemin amerikan të vlerësimit, është burim ngatërrese dhe pasaktësi në vlerësim.

Rekomandojmë hartimin e rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë mes tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit. Duke qenë se konvertimi i pikëve të vlerësimit në notë është i njëjti, në syllabuse apo rregulloren e

	<i>prograzmit të studimit nuk është e nevojshme të paraqite, është mjaftueshëm të citohet si referencë rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies</i> AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies Ev-10-Programi Mësimor i Masterit Profesional “Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	NA
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është hartuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me VKM nr. 41, datë 24.01.2018,

përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”, e ndryshuar. Programi është i strukturuar në 60 kredite ECTS, me një kohëzgjatje normale prej një viti akademik dhe realizohet në formën e studimeve me kohë të plotë. Ky format siguron një përfshirje të plotë të studentëve në procesin mësimor dhe kërkimor, duke garantuar arritjen e rezultateve të të nxënit në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë. Studimet përmbillen me mbrojtjen e diplomës përfundimtare, e cila përbën një komponent të detyrueshëm vlerësues dhe integrues të kompetencave të fituara gjatë programit. Pas përfundimit me sukses të ciklit të studimeve, studentit i akordohet diploma “Master Profesional”, e cila vërteton përgatitjen e tij të specializuar në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit. Ky strukturim konfirmon se programi është në përputhje të plotë me standardet ligjore, akademike dhe profesionale të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe garanton koherencë ndërmjet formimit teorik, praktik dhe kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes kibernetike.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	AFA ka zbatuar një sistem të kodifikimit për programet e studimit që ofron brenda fushës së saj të veprimtarisë. Në këtë kuadër, programi i Masterit Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është ndërtuar në përputhje me këto standarde dhe reflekton përmbajtje të krahasueshme, në masën prej rreth 70%, me programet e tjera të ngjashme të ciklit të dytë, të ofruara në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtim. Kjo përputhje garanton koherencë akademike dhe harmonizim me praktikatat kombëtare në arsimin e lartë. Vihet re që ky program studimi ofrohet edhe në IAL të tjera kombëtare ku mund të përmendim: 1. Universiteti Luarasi 2. Universiteti i Tiranës Vihet re që në këto Universitete ka rreth 70% ngjashmëri mbi përmbajtjen e programit të ofruar nga Akademia e Forcave të Armatosura.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të	Programi i studimit është i pajisur me një kod specifik, i cili përcaktohet në bazë të fushës përkatëse të studimit dhe në përputhje me klasifikimet e miratuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. AFA ka zbatuar këtë praktikë edhe për

bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	programin e Masterit Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, duke i atribuar atij një kod unik që siguron identifikimin dhe klasifikimin zyrtar të programit brenda sistemit të arsimit të lartë.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA			
Konkluzione	<i>Lëndët në tërësi, plani mësimor dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh.</i> <i>Numri i orëve në auditor i parashikuar për aktivitetet didaktike, është konform VKM 41 e ndryshuar.</i> <i>Institucioni duhet të rishikojë rregulloret për uniformimin e tyre për pjesën e vlerësimit të dijeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Personeli Akademik në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë për vitin akademik 2023-2024, përbëhet nga 56 PAE dhe 12 PAK, nga të cilët PAE janë 23 me grada e tituj dhe PAK janë 3. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit për vitin akademik 2023-2024, përbëhet nga 7 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe 9 anëtar personeli akademik me kontratë, ku ndahen sipas gradat dhe titujt si më poshtë: Personel akademik efektiv: - 1 Prof.Dr. - 2 Prof.As. - 3 Dr.

	- 1 Msc. Personel akademik me kontratë: - 1 Prof.Dr. - 2 Dr. - 6 Msc Ekuivalentimi i gradave ushtarake me grada dhe titull shkencor, vetëm për efekt te veprimtarisë akademike kryhet sipas VKM nr. 156 date 19.02.2020
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se praktika profesionale, si komponent thelbësor i programit të studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, realizohet në institucione dhe organizata që janë në përputhje me profilin akademik dhe profesional të studentëve. Procesi i zhvillimit të praktikës është i strukturuar dhe i mbikëqyrur, duke siguruar cilësi dhe koherencë midis objektivave të programit dhe eksperiencës praktike. Praktika monitorohet nga: Personi përgjegjës për programin e studimit, i cili mban gradën shkencore “Dr.” dhe ka rol drejtues në garantimin e cilësisë akademike të procesit; Përfaqësuesi i institucionit/kompanisë pritëse, i cili mbikëqyr dhe udhëheq studentin gjatë realizimit të detyrave praktike. Grupi vëren se në organikën e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) dhe të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit nuk është i parashikuar staf ndihmës akademik. Megjithatë, funksionet mbështetëse në administrimin e praktikës dhe koordinimin me institucionet pritëse realizohen përmes bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe strukturave administrative të fakultetit, duke siguruar zhvillimin e praktikave në përputhje me kërkesat e programit dhe standardet institucionale të Akademisë së Forcave të Armatosura. Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës Ev-6-Rregullore e Programit të Studimit Ev-20-Institucionet me të cilat zhvillohet praktika profesionale.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në	GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” ofrohet në nivel departamenti, dhe zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e tjera bazë të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS), me qëllim sigurimin e

rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	një zbatim të integruar dhe efektiv të veprimtarive akademike dhe praktikave profesionale. Në këtë kuadër, përgjegjësi i departamentit ushtron funksionin e koordinatorit të programit të studimit, duke pasur rol drejtues dhe përgjegjësi të plotë për: • monitorimin e ecurisë akademike të programit, • koordinimin e zhvillimit të praktikave profesionale, • dhe sigurimin e përputhshmërisë së të gjitha veprimtarive me objektivat akademike dhe formuese të programit. Ky organizim institucional garanton një bashkërendim të mirëfunksionuar ndërmjet njësive të fakultetit, duke mundësuar implementimin e standardeve akademike dhe profesionale të Akademisë së Forcave të Armatosura në realizimin e programit të studimit dhe përgatitjen e specialistëve në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit.			
Konkluzione	<i>Në tërësi njësia bazë përmbush detyrimet ligjore për ofrimin e këtij programi studimi por rekomandohet të ketë mbulim të lëndëve me staf të brendshëm akademik si dhe nevoja për staf ndihmës akademik. Vihet re që ka më shumë staf të jashtëm akademik se sa të brendshëm me profil në fushën e sigurisë kibernetike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	I gjithë personeli i Akademisë së Forcave të Armatosura ka të drejtë dhe mundësi akses në sistemet e menaxhimit të brendshëm që institucioni ka në funksion. Për administrimin dhe shpërndarjen e dokumentacionit, AFA përdor platformën "SHARE AFA", e cila mundëson organizimin efikas të informacionit dhe ofron akses të centralizuar për të gjitha strukturat dhe punonjësit. Pedagogët, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, e përdorin këtë platformë për të mbështetur procesin mësimor dhe për të përmirësuar ndërveprimin akademik. Në të njëjtën kohë, sistemet e informacionit në AFA janë të strukturuar për të ofruar shërbime dhe akses të personalizuar për stafin akademik, studentët dhe aktorë të tjerë të përfshirë. Të dhënat që lidhen me programet e studimit,

	ofertat arsimore, personelin akademik dhe aktivitetet institucionale bëhen të disponueshme publikisht përmes faqes zyrtare të internetit në gjuhën shqipe.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programet e studimit në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) janë të strukturuar në lëndë, module, orë laboratorike, praktikë dhe aktivitete formuese, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Këto elemente janë të detajuara në planin mësimor dhe në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të cilat përcaktojnë mënyrën e zhvillimit, vlerësimit dhe shpërndarjes së ngarkesës akademike për studentët. Në mënyrë të veçantë, programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i ndarë në dy semestra, me nga 30 kredite për secilin semestër, duke arritur një total prej 60 kreditesh ECTS për të gjithë ciklin e studimeve. Ky strukturim siguron koherencë ndërmjet komponentëve teorikë, praktik dhe formues, duke u orientuar drejt përgatitjes së studentëve me njohuri të balancuara akademike dhe profesionale, në përputhje me objektivat e programit dhe standardet evropiane të arsimit të lartë. Plani mësimor i programit jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale, orë laboratorike për çdo lëndë të programit.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se rregullorja e programit të studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” përmban dispozita të qarta dhe të detajuara që rregullojnë procedurat e pranimi, afatet e studimit dhe transferimin e studentëve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA). Në Kreun “Pranimi i studentëve dhe afatet e studimit”, përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat që kandidatët duhet të plotësojnë për t’u pranuar në programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional në këtë profil. Këto dispozita garantojnë transparencë dhe objektivitet në procesin e përzgjedhjes, duke u bazuar në meritë

akademike, përputhshmëri të diplomës paraprake dhe vlerësim profesional të kandidatit.

Gjithashtu, në Nenin 11 "Transferimi i studentëve", rregullorja përcakton procedurat dhe kriteret për pranimin e transferimeve brenda dhe jashtë institucionit, duke siguruar respektimin e parimit të ekuilibrit të krediteve dhe përputhshmërisë së programeve.

Procesi i pranimit dhe transferimit mbështetet në një bazë të gjerë rregullative, përfshirë:

- Rregulloren e përgjithshme të AFA,
- Rregulloren e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS),
- Rregulloren e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit,
- si dhe Rregulloren specifike të programit të studimit.

Ky sistem rregullativ i integruar siguron koherencë, standarde të unifikuara dhe transparencë institucionale në proceset e pranimit, regjistrimit dhe transferimit të studentëve në programin e studimit.

Megjithatë, ka një mospërputhje në sistemin e vlerësimit mes rregullores së zhvillimit kurrikular dhe asaj të programit të studimit, ku për referencë është paraqitur edhe në standardet më sipër, dhe po risilliet këtu në formë tabelare krahasimi i mënyrave të vlerësimit.

Rr. Zhvillim Kurrikular Si dhe Suplmenti i diplomës			Rr. Program studimi		
Pikë	Notë	Shkronjë	Pikë	Notë	Shkronjë
96-100	10	A+	94-100	10	A
86-95	9	A	85-93	9	A-
76-85	8	B+	76-84	8	B
66-75	7	B	67-75	7	B-
56-65	6	C+	58-66	6	C
46-55	5	C	51-57	5	D
≤45	4	M	≤50	4	F
Nuk ka realizuar kredite të lëndës		P	-	-	-

	Nga ku dukshëm këto dy sisteme vlerësimi nuk janë në sinkron mes tyre, si në vlerësimin me bazë 100 (pikë), ashtu edhe në ekuivalentimin e tyre me gërmë. Ky informacion, për studentët e diplomuar, të cilët janë të pajisur me suplementin e diplomës, mund të mos jetë burim ngatërrese në rast transferimi studimesh, por për studentët që nuk janë diplomuar, dhe duan të realizojnë transferimin e studimeve nga AFA drejt një institucioni tjetër të arsimit të lartë që përdor sistemin amerikan të vlerësimit, është burim ngatërrese dhe pasaktësi në vlerësim. Evidenca 6: Rregullore e Programit të Studimit Ev-23-Rregullore e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se informacioni i detajuar për çdo lëndë të programit të studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është i strukturuar dhe dokumentuar në syllabus-in përkatës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike në fuqi. Çdo syllabus përgatitet dhe miratohet përpara fillimit të vitit akademik nga titullari i lëndës në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, duke garantuar që përmbajtja e lëndës, rezultatet e të nxënësve dhe mënyrat e vlerësimit të jenë të harmonizuara me objektivat e programit dhe me strategjinë mësimore të fakultetit. Hartimi i syllabus-eve bazohet në udhëzimet e përcaktuara në Shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit”, e cila përcakton formatin dhe elementet thelbësore që duhet të përmbajë çdo syllabus, përfshirë: • të dhënat identifikuese të lëndës, • rezultatet e pritura të të nxënësve, • përmbajtjen tematike dhe orët përkatëse, • metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, • literaturën bazë dhe plotësuese, • si dhe kriteret e vlerësimit të studentëve. Kjo praktikë e standardizuar siguron koherencë akademike, transparencë dhe cilësi në procesin e mësimdhënies, duke e bërë të qartë për studentët strukturën, objektivat dhe kërkesat e çdo lënde që përbën programin e studimit.

	Ev-22-Syllabuset e lëndëve, viti akademik 2023-2024.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” ndjek një proces të rregullt dhe të qëndrueshëm të rishikimit periodik të planit mësimor, disiplinave mësimore dhe veprimtarive formuese, në përputhje me praktikën e sigurimit të cilësisë dhe kërkesat ligjore dhe institucionale në fuqi. Ky rishikim kryhet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim përshtatjen e përmbajtjes akademike me ndryshimet e tregut të punës, zhvillimet teknologjike dhe dinamikën e brendshme të institucionit. Në këtë proces, drejtuesi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit (DTI), në bashkëpunim me personelin akademik, realizon analiza periodike në fillim të çdo viti akademik, duke shqyrtuar trendet më të fundit në fushën e sigurisë kibernetike dhe nevojat e identifikuara në sektorin e mbrojtjes dhe inovacionit digjital. Këto analiza shërbejnë si bazë për propozime konkrete për përmirësimin e lëndëve, si në aspektin didaktik dhe metodologjik, ashtu edhe në përditësimin e literaturës mbështetëse, duke u siguruar që studentët të kenë qasje në burime të përditësuara dhe relevante. Në kuadër të bashkëpunimeve të DTI me institucionet partnere dhe takimeve periodike me studentët e programit të Masterit Profesional, janë propozuar dy ndryshime për përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve, konkretisht: Lënda “Bazat e Teknologjisë” të zgjerohet me tema në fushën e Kriptografisë, duke thelluar aspektet praktike të sigurisë së të dhënave; Lënda “Thellimi dhe Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike / Qeverisja dhe Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike” të përfshijë tema në fushën e Digital Forensics, duke reflektuar nevojat aktuale për hetim dhe analizë të incidenteve kibernetike. Këto ndryshime dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për përmirësim dhe përshtatje me zhvillimet bashkëkohore, duke e bërë programin më relevant, praktik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të arsimit në fushën e sigurisë kibernetike.
	Ev-27-Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies.

Konkluzione	<i>Programi i studimit është i detajuar, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese. Në syllabuse përcaktohen peshat e vlersimit për seminarët, detyrat e kursit apo projektet, provimet e pjesshme dhe ato përfundimtare. Rekomandohet të ketë në disa lëndë orë laboratorike të përcaktuara mire dhe të shtrira në programin e studimit.</i> <i>Rekomandohet rishikimi dhe unifikimi i rregulloreve të lidhura me këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit është strukturuar për t'i ofruar studentit një formim të plotë, me theks të veçantë në përgatitjen praktike, duke synuar përvetësimin e njohurive teorike dhe profesionale që i nevojiten për punësim apo për specializim në një profil të caktuar. Emërtimi i programit përkon plotësisht me fushën që trajton, duke reflektuar përmbajtjen dhe objektivat e tij. Struktura e programit përfshin një kombinim të balancuar të lëndëve teorike, aktiviteteve praktike dhe komponentëve të aplikuar, të konceptuara për të garantuar që studenti të fitojë njohuri të avancuara akademike dhe kompetenca praktike në fushën e Sigurisë Kibernetike dhe të Informacionit. Në këtë mënyrë, emri i programit përfaqëson saktësisht përmbajtjen dhe shërbimet profesionale për të cilat ai përgatit studentët. Komponentët mësimorë janë në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun e lëndës dhe të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe praktik. Ev-6-Rregullore e programit të studimit MP në "Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes".
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore	Gjatë vitit akademik, procesi mësimor në AFA është i organizuar në dy semestra, secili me një kohëzgjatje standarde prej 15 javësh. Ngarkesa mësimore është e shpërndarë në mënyrë të baraspeshuar ndërmjet semestrave, duke i krijuar studentit mundësi reale për të

mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	përvetësuar njohuritë dhe për të arritur kompetencat e nevojshme profesionale. Lëndët apo modulet, së bashku me ndarjen e tyre në vite dhe semestra, si dhe raporti mes orëve mësimore dhe krediteve (ECTS), janë hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Kjo strukturë synon gjithashtu të harmonizohet me praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe me direktivat kombëtare dhe evropiane në fushën e arsimit të lartë. Të gjitha këto elemente janë të përfshira në mënyrë të qartë në planin mësimor të programit. Përmbajtja dhe ngarkesa e secilës lëndë/moduli siguron ndërthurjen efektive të njohurive teorike me ato praktike, duke garantuar një formim të plotë dhe të orientuar drejt aftësimit profesional.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i Masterit Profesional "Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" është konceptuar duke u mbështetur në praktikatat më të avancuara ndërkombëtare, duke marrë parasysh sfidat aktuale në fushën e sigurisë kibernetike dhe eksperiencat e akademike që operojnë në kuadër të strukturave të NATO-s. Ndërtimi i tij është orientuar nga modele të suksesshme të vendeve të zhvilluara dhe është mbështetur në literaturë shkencore dhe profesionale bashkëkohore, e cila përdoret gjerësisht në universitetet më të njohura ndërkombëtare që ofrojnë programe studimi në këtë fushë. Programi i studimit Master Profesional "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" është konceptuar për të ofruar një balancë të qëndrueshme midis njohurive teorike dhe atyre praktike, duke u siguruar që studentët të fitojnë kompetenca të plota për analizë, vendimmarrje dhe zbatim profesional në fushën e sigurisë kibernetike, mbrojtjes dhe menaxhimit të informacionit. Programi synon zhvillimin e autonomisë në proceset e vendimmarrjes, aftësisë për të analizuar situata komplekse që mund të hasen në praktikën profesionale dhe për të propozuar zgjidhje të bazuara në njohuri shkencore dhe teknike. Vlerësimi i raportit teori/praktikë tregon se programi arrin një përafrim të kënaqshëm me standardet evropiane për programe të ngjashme në këtë fushë. Kjo evidentohet në mënyrën se si komponentët teorikë ndërthuren me praktikatat laboratorike, simulimet teknike dhe aktivitetet profesionale, duke garantuar përgatitjen e studentëve për sfidat reale të mjedisit kibernetik dhe të sigurisë kombëtare. Në përfundim, grupi vlerëson se struktura aktuale e programit siguron koherencë ndërmjet formimit akademik dhe aplikimit praktik, në përputhje me parimet e Arsimit të Lartë Evropian (ESG)

	dhe me nevojat specifike të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë në Shqipëri. Evidenca 26: Praktika e miratimit të planeve dhe programeve mësimore, Master Profesional në Siguria
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është projektuar për të mundësuar arritjen e objektivave formues, si dhe për të lehtësuar transferimin e studimeve, mobilitetin akademik dhe punësimin e të diplomuarve në përfundim të ciklit të dytë të studimeve. Për realizimin e këtyre objektivave, programi ofron një ndërthurje të balancuar midis formimit teorik dhe atij praktik, duke u mbështetur në praktikat më të mira të universiteteve dhe akademive partnere ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit. Struktura e veprimtarive mësimore në auditor është e përcaktuar qartë në planin mësimor të programit, në përputhje me numrin e krediteve ECTS që i korrespondon çdo disipline. Ajo përfshin ndarjen e ngarkesës në: • Leksione – për zhvillimin e bazës teorike dhe koncepteve kryesore; • Seminare – për analizë të rasteve konkrete dhe diskutim interaktiv; • Projekte dhe laboratorë – për aplikimin praktik të njohurive në situata teknike dhe eksperimentale; • Praktika profesionale – për përvojë reale në institucione dhe organizata që operojnë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kibernetike. Kjo strukturë didaktike siguron koherencë ndërmjet përmbajtjes akademike dhe kërkesave të tregut të punës, duke i pajisur studentët me kompetenca të transferueshme dhe profesionale që mbështesin punësueshmërinë, mobilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të karrierës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes digjitale. Ev-10-Programi Mësimor i Masterit Profesional “Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit bën rishikimin dhe përditësimin periodik të literaturës bazë dhe të detyrueshme që mbështet programin e studimit. Në këtë proces, përgjegjësi i departamentit, në bashkëpunim të ngushtë me titullarët e lëndëve, analizojnë dhe rivlerësojnë syllabus-et përkatëse në fillim të çdo semestri, me qëllim që literatura e rekomanduar të jetë në përputhje me zhvillimet më të fundit shkencore dhe akademike. Prioritet i jepet botimeve të realizuara nga shtëpi botuese të njohura ndërkombëtare dhe vendase, duke u siguruar që ato të jenë të përditësuara dhe të mos jenë më të vjetra se pesë vitet e fundit.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është ndërtuar mbi një qasje të integruar midis teorisë dhe praktikës, duke synuar të sigurojë një formim të plotë profesional dhe akademik për studentët. Programi synon përvetësimin e dijeve bashkëkohore dhe teknologjike në fushën e sigurisë kibernetike, duke i inkurajuar studentët të zhvillojnë mendim krijues, analitik dhe kritik, në përputhje me parimet dhe objektivat e një programi Master Profesional. Kjo ndërthurje teoriko-praktike ndihmon studentët të kuptojnë thellë konceptet themelore, por edhe t'i aplikojnë ato në situata reale, duke i përgatitur për sfidat konkrete të mjedisit profesional në sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë së informacionit. Në këtë mënyrë, programi kontribuon në formimin e specialistëve të aftë për të analizuar, projektuar dhe menaxhuar zgjidhje inovative në fushën e sigurisë kibernetike, në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit profesional dhe kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është i strukturuar në mënyrë të tillë që t'i ofrojë studentit një formim të plotë dhe praktik, të orientuar drejt përgatitjes profesionale dhe punësimit në fusha kyçe të sigurisë kibernetike dhe të informacionit. Programi synon të kualifikojë specialistë të aftë për të vepruar në sektorë të ndryshëm, si: • administrata publike, • sistemi bankar dhe financiar,

	- operatorët e komunikimeve elektronike dhe të telefonisë mobile, - si dhe strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Përmbajtja e tij është projektuar për të zhvilluar aftësi praktike dhe profesionale, duke kombinuar formimin teorik me trajnimin në situata reale pune. Në këtë mënyrë, programi siguron që studentët të fitojnë kompetenca të menjëhershme të aplikueshme në mjedise institucionale dhe teknologjike komplekse. Ev-17-Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese të programit Master Profesional "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes".			
Konkluzione	<i>Struktura e programit si dhe raporti teori praktikë është kryesisht në përputhje me profilin e programit të studimit, gjithsesi rekomandohet të ketë më shumë module praktike. Programi siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e sigurisë kibernetike. Rekomandohet rishikimi i kurrikulës periodikisht sipas dinamikave të tregut të punës dhe direktivave të Ministrisë së Mbrojtjes në fushën e sigurisë kibernetike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Sipas akteve të brendshme rregullative, çdo program studimi i AFA-s i nënshtrohet konsultimeve periodike me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës në fushën e teknologjisë së informacionit. Këto përfshijnë përfaqësues nga sektori i biznesit, shërbimeve dhe profesionistë të fushave përkatëse. Qëllimi i këtij procesi është të sigurohet që përmbajtja e programit të jetë në përputhje me kërkesat aktuale dhe në zhvillim të tregut të punës. Në përputhje me këto konsultime, programi mund të pësojë ndryshime apo përditësime për të reflektuar sa më mirë nevojat dhe prioritetet e sektorit profesional, duke garantuar një formim të qëndrueshëm dhe të aplikueshëm për studentët.

Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (TI) në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) mban një komunikim të vazhdueshëm dhe aktiv me studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve të tyre, duke siguruar pjesëmarrje të plotë dhe të qëndrueshme të tyre në jetën akademike dhe institucionale. Marrja e mendimit të studentëve realizohet në mënyrë të sistematizuar përmes instrumenteve të formalizuara të vlerësimit, ndër të cilët më i rëndësishmi është pyetësi studentor, i cili përdoret për të mbledhur feedback mbi cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndëve dhe mënyrën e organizimit të procesit akademik. Përveç pyetësorëve, praktikohen edhe forma të tjera interaktive të komunikimit, si: • diskutime të drejtpërdrejta me pedagogët gjatë orëve të mësimi, • konsultime për literaturën dhe metodikat e reja të mësimdhënies, • takime periodike mes studentëve dhe strukturave drejtuese të fakultetit. Grupi vlerëson se studentët janë të përfshirë në mënyrë aktive në jetën institucionale të AFA-së, duke pasur përfaqësim të garantuar në aktet themelore të institucionit. Kjo përfshirje realizohet nëpërmjet: • Këshillit Studentor Institucional, • Këshillave Studentorë në nivel fakultetesh, • si dhe përfaqësimit në Senatin Akademik, NJSBC, dhe komisionet e përhershme në nivel institucional dhe fakulteti. Kjo strukturë e gjerë pjesëmarrjeje u mundëson studentëve të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre jo vetëm mbi procesin mësimor, por edhe gjatë vendimmarrjes finale për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Ky mekanizëm dëshmon për një kulturë institucionale bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse, që forcon angazhimin e studentëve si partnerë aktivë në sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin akademik të institucionit.
--	--

	Ev-32-Vendim i Senatit Akademik të AFA “Për miratimin e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional”.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” ka për qëllim të zhvillojë aftësi dhe shprehi profesionale tek studentët, në mënyrë që ata të përgjigjen me kompetencë kërkesave dinamike të tregut të punës, në fushat e sigurisë kibernetike, teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjes digjitale. Bashkëpunimi përbën një komponent thelbësor të veprimtarisë akademike, duke u realizuar përmes organizimit të leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e ekspertëve të sigurisë kibernetike nga institucione partnere ose entitete me të cilat AFA ka marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi. Këta specialistë kontribuojnë duke ndarë përvojat dhe njohuritë e tyre më të fundit, çka i mundëson Departamentit të përfshijë perspektiva të reja dhe aktuale në programin e studimit. Gjithashtu, këto aktivitete nxisin ndërveprimin me një rrjet të gjerë profesionistësh, organizatash dhe shoqatash të profilizuara në këtë fushë. Evidenca 15: Institucionet bashkëpunuese me AFA.			
Konkluzione	<i>Programi siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e sigurisë kibernetike. Rekomandohet rishikimi i kurrikulës periodikisht sipas dinamikave të tregut të punës dhe takime me aktorët kryesore si dhe direktivave të Ministrisë së Mbrojtjes në fushën e sigurisë kibernetike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi reflekton misionin formues, kërkimor dhe profesional të arsimit të lartë, duke synuar përgatitjen e specialistëve të kualifikuar në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit, të aftë për të kontribuar në modernizimin dhe mbrojtjen e infrastrukturave kritike kombëtare.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit,	Institucioni vlerëson dhe evidenton arritjet e personelit të tij akademik dhe kërkimor përmes analizave vjetore që zhvillohen në

bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	nivel departamenti, fakulteti dhe në shkallë institucionale, duke u fokusuar si në aspektin mësimor ashtu edhe në atë shkencor. AFA mbështet dhe inkurajon vazhdimisht zhvillimin profesional të stafit akademik, duke promovuar pjesëmarrjen në programe trajnimi dhe mobilitet në universitete të njohura perëndimore, përmes shfrytëzimit të çdo mundësie bashkëpunimi ndërkombëtar. Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë akademish dhe institucione arsimore ushtarake, përfshirë Akademinë Ushtarake të SHBA "West Point", si dhe institucione homologe në Itali, Greqi, Maqedoninë e Veriut, Bullgari dhe Gardën Kombëtare të Neë Jersey-t, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe rritjen profesionale të personelit. AFA gjithashtu garanton të drejtën e personelit të saj për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe sociale jashtë institucionit, me kusht që këto angazhime të mos bien ndesh me përgjegjësitë mësimore dhe detyrimet e tjera të lidhura me marrëdhënien e punës. Ev-6-Rregullore e programit të studimit të MP në "Siguria Kibernetike nw fushwn e mbrojtjes"
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	AFA inkurajon dhe mbështet aktivisht shkëmbimin e përvojave, bashkëpunimin dhe dialogun social ndërmjet studentëve, personelit akademik e administrativ dhe aktorëve të ndryshëm, përfshirë institucione shtetërore dhe joqeveritare, shoqata profesionale dhe individë të fushave të ndryshme. Qëllimi i këtij angazhimi është rritja e përfshirjes dhe ndërtimi i një komuniteti aktiv në jetën sociale dhe akademike. Përmes organizimit të aktiviteteve brenda dhe jashtë ambienteve të institucionit, AFA u krijon studentëve mundësinë të jenë pjesë aktive në diskutime, të japin kontributin e tyre dhe të shprehin mendimet për tema me rëndësi shoqërore, profesionale apo akademike, duke nxitur ndjenjën e qytetarisë dhe përgatitjen për përfshirje në jetën publike.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) demonstroi një angazhim të qëndrueshëm për zhvillimin profesional dhe akademik të personelit të saj. Institucioni nxit, mbështet dhe inkurajon stafin akademik për kualifikim të mëtejshëm brenda dhe jashtë vendit, duke krijuar një mjedis motivues dhe mbështetës për rritje të vazhdueshme profesionale. Ky angazhim konkretizohet nëpërmjet disa mekanizmave efektivë, si:

	- Realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe kombëtare e ndërkombëtare, që nxisin mobilitetin akademik dhe shkëmbimin e eksperiencave; - Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme në institucion me lektorë dhe ekspertë të njohur në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe teknologjisë; Organizimi periodik i konferencave shkencore në bashkëpunim me institucione partnere dhe akademi homologe. Gjithashtu, AFA vlerëson dhe evidenton arritjet e stafit të saj akademik, duke i reflektuar këto në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore, të zhvilluara në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni. Ky sistem i integruar mbështetjeje dhe vlerësimi kontribuon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale të AFA-së për përmbushjen e misionit të saj akademik dhe kombëtar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Edhe pse institucioni ka një politikë të miratuar për mbështetjen e autonomisë, lirisë akademike dhe financiare, vërehet se stafi i angazhuar në këtë program studimi, dhe në tërësi i njësisë bazë përkatëse, nuk ka një mbështetje financiare të mjaftueshme për realizimin e kërkimeve shkencore specifike në fushën e tyre të kompetencës. Kjo vërehet edhe nga numri i ulët i botimeve shkencore apo pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, përtej atyre të organizuara nga vet institucioni, apo ato me karakter ushtarak si pjesë e forcave të armatosura. AN-4.6-Dëshmi respektimit autonomisë, lirisë akademike financiare AN-4.8-Politikia zhvillimit stafit akademik Ev-14 Raporti mbi veprimtarine Akademike dhe Kërkimore Shkencore			
Konkluzione	<i>Institucioni vihet re që ka angazhuar studentët në aktivitete të ndryshme si hackathone apo aktivitete të ngjashme në fushën e sigurisë kibernetike. Rekomandohet që këto aktivitete të jenë më të shpeshta gjatë programit të studimit dhe sa më shumë konkurruese. Rekomandohet një mbështetje më e mirë për kërkimin shkencor</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7 Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) zhvillon një veprimtari të gjerë kërkimore dhe shkencore, në përputhje me misionin e saj institucional për krijimin dhe shpërndarjen e njohurive në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe teknologjisë. Përveç konferencës shkencore vjetore, njësitë kryesore akademike të AFA-së organizojnë konferenca të specializuara në përputhje me drejtimet e tyre kërkimore specifike, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe promovimin e rezultateve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve. Një element i veçantë i politikës kërkimore të institucionit është motivimi i grupeve kërkimore për të publikuar gjetjet e tyre në “Revistën Ushtarake” të AFA-së, si dhe në revista shkencore të indeksuara ndërkombëtarisht, çka ndihmon në rritjen e dukshmërisë dhe impaktit akademik të institucionit. Grupi vlerëson gjithashtu se personeli akademik është aktiv në projekte kërkimore, marrëveshje bashkëpunimi dhe konferenca ndërkombëtare, si në mënyrë individuale, ashtu edhe në kuadër institucional. Këto veprimtari kontribuojnë në: • forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, • rritjen e ndërkombëtarizimit të AFA-së, • shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, Ev-15-Institucionet bashkëpunuese me AFA
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	AFA mbështet dhe inkurajon çdo nismë që synon përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në veprimtari kërkimore-shkencore. Institucioni mbulon financiarisht publikimet e realizuara në Revistën Ushtarake dhe në konferencat shkencore të organizuara nga vetë AFA, duke ofruar honorare për çdo artikull të paraqitur nga stafi akademik apo studentor, në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 120/1997. Përmes politikave të saj institucionale, AFA ka nxitur pjesëmarrjen aktive të stafit në konferenca shkencore dhe aktivitete ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, duke i konsideruar këto si hapësira të rëndësishme për përballjen me zhvillimet bashkëkohore në kërkimin shkencor. Kontributi i stafit në këto forume ka prodhuar

	rezultate domethënëse në fushat ku AFA zhvillon veprimtarinë e saj akademike dhe profesionale. Në funksion të shkëmbimit të përvojave dhe harmonizimit me standardet akademike ndërkombëtare, AFA ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda vendit. Për të promovuar arritjet në fushën e kërkimit shkencor, si dhe për të vlerësuar kontributin e stafit të saj, institucioni organizon në mënyrë periodike ceremoni vlerësimi dhe promovimi, me pjesëmarrjen e personaliteteve nga fusha akademike, ushtarake dhe kulturore. Stafi akademik i AFA-s ka një portofol të gjerë me artikuj, referate, kumtesa dhe monografi të botuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe ato me faktor impakti. E gjithë kjo veprimtari kërkimore mbështetet nga rrjeti i bashkëpunimeve që institucioni ka ndërtuar me partnerët e tij vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe nga aktet dhe urdhrat rregullues të autoriteteve përkatëse në fushën e arsimit, mbrojtjes dhe sigurisë.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) zhvillon një veprimtari të qëndrueshme shkencore dhe kërkimore, duke krijuar një mjedis aktiv për shkëmbimin akademik dhe promovimin e rezultateve të kërkimit. Në mënyrë të rregullt, AFA organizon konferencën shkencore vjetore, ku marrin pjesë personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm, si edhe kërkues shkencorë nga universitete partnere kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky aktivitet përbën një platformë të rëndësishme për prezantimin e punimeve kërkimore, shkëmbimin e eksperiencave dhe nxitjen e bashkëpunimeve të reja akademike. Përveç kësaj konference, njësitë kryesore të AFA-së organizojnë konferenca shkencore sipas drejtimeve të tyre specifike, duke kontribuar në thellimin e kërkimit shkencor në fusha të veçanta të mbrojtjes, sigurisë dhe teknologjisë së informacionit. Grupi vlerëson gjithashtu se AFA inkurajon dhe motivon grupet kërkimore për të publikuar gjetjet e tyre në “Revistën Ushtarake”, si edhe në revista të tjera shkencore të indeksuara, duke promovuar kulturën e kërkimit dhe të botimit akademik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

	Një praktikë e veçantë e vlerësuar është përfshirja aktive e studentëve të programeve master në evente kombëtare, hackathone dhe konkurse teknologjike, ku ata prezantojnë rezultatet e kërkimeve dhe projekteve të tyre inovative. Kjo nismë kontribuon në forcimin e kompetencave praktike, kërkimore dhe bashkëpunuese të studentëve, duke i afruar ata me tregun e punës dhe mjedisin profesional të fushës së sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes. Në përfundim, grupi vlerëson se këto veprimtari përbëjnë një model të mirë institucional për integrimin e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe zhvillimit profesional, në përputhje me misionin akademik dhe strategjinë e zhvillimit të AFA-së. Evidenca 39: Strategjia e Kërkimit Shkencor në AFA.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është projektuar me një qasje të qartë profesionale dhe praktike, me qëllim përgatitjen e specialistëve të kualifikuar dhe konkurrues në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi ndërthur në mënyrë të balancuar formimin akademik teorik me trajnimet praktike, duke mbuluar një gamë të gjerë temash që lidhen me sigurinë e informacionit, mbrojtjen kibernetike dhe menaxhimin teknologjik të riskut. Qëllimi i tij është të zhvillojë tek studentët njohuri të avancuara dhe aftësi profesionale në fusha thelbësore të sigurisë kibernetike, përfshirë: • Identifikimin dhe parandalimin e kërcënimeve kibernetike, • Vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve, • Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për mbrojtjen e informacionit dhe infrastrukturës kritike. Hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe protokolleve të sigurisë. Grupi vlerëson se struktura e programit është ndërtuar në përputhje me standardet evropiane të arsimit profesional, duke siguruar që studentët të fitojnë kompetenca të transferueshme, aftësi analitike dhe eksperiencë praktike që i bëjnë ata të aftë për integrim të

	menjëhershëm në tregun e punës dhe për të kontribuar në forcimin e sigurisë kombëtare dhe dixhitale të vendit. Ky orientim profesional dhe praktik reflekton një koherencë të plotë midis objektivave të programit dhe nevojave aktuale të tregut, si dhe përmbush misionin institucional të AFA-së për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në fushën strategjike të sigurisë dhe mbrojtjes.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	NA			
Konkluzione	<i>Kërkimi shkencor ngelet një nga elementët më të rëndësishëm që AFA duhet të mbështesë stafin akademik me instrumenta dhe burime financiare konkrete dhe të mirë dedikuara. Nga ana e AFA vihet re organizmi i konferencave shkencore periodike apo botimeve periodike në revistën që AFA disponon si dhe nxitjen e stafit akademik dhe studenteve për pjesmarrje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” realizohet me një vëllim total prej 60 kreditesh ECTS, në përputhje me planin mësimor të hartuar nga Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) dhe të miratuar nga Senati Akademik i Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA). Programi është i strukturuar sipas standardit evropian të ngarkesës së studentit, duke garantuar koherencë ndërmjet ngarkesës teorike, orëve praktike dhe aktiviteteve formuese. Vlerësimi i performancës akademike të studentëve në këtë program kryhet në mënyrë të strukturuar dhe shumëpërmasore, duke marrë parasysh disa komponentë kryesorë, si: • Pjesëmarrja dhe aktivizimi i studentit gjatë leksioneve dhe seminareve; • Vlerësimi i detyrës së kursit ose projektit individual/grupor; • Provimi i ndërmjetëm, i cili teston njohuritë e fituara në fazat paraprake të lëndës; Provimi përfundimtar, që përfaqëson përmbledhjen e kompetencave teorike dhe praktike të studentit. Vlerësimi përfundimtar i studentit për secilën lëndë/modul është rezultat i kombinimit të këtyre katër komponentëve, të cilët shkallëzohen në sistemin e pikëve dhe konvertohen në notë përfundimtare, në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe aktet përkatëse institucionale. Grupi vlerëson se ky sistem vlerësimi siguron transparencë, objektivitet dhe reflektim real të arritjeve të studentëve, duke kontribuar në ruajtjen e standardeve të cilësisë akademike dhe profesionale të programit.

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) garanton një mjedis të përshtatshëm, gjithëpërfshirës dhe interaktiv për zhvillimin e procesit mësimor, në përputhje me parimet bashkëkohore të arsimit të lartë. Personeli akademik respekton dhe zbaton një qasje student-qendrore, duke ofruar një klimë pozitive bashkëpunimi dhe diskutimi, si dhe mundësi për punë në grup, praktikë të udhëhequr dhe të pavarur, që i përgjigjen nevojave dhe interesave të ndryshme të studentëve. Në këtë kuadër, metodologjitë e përdorura në auditor janë të orientuara drejt përfshirjes aktive të studentit në procesin e të nxënës, përmes teknikave inovative si: • Raste studimore dhe analiza të situatave reale; • Role play për simulimin e situatave praktike; • Punë në grup dhe projekte bashkëpunuese; • Learning by doing, që nxit aplikimin e njohurive në mënyrë praktike; Përdorimi i mjeteve audio–video dhe softuerëve profesionalë për zhvillimin e aftësive analitike dhe teknike. Këto metoda janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, të cilët kanë evidentuar rritjen e angazhimit, ndërveprimit dhe kompetencave praktike gjatë procesit të të nxënës. Grupi vlerëson gjithashtu se AFA ka krijuar një infrastrukturë moderne didaktike, që mbështet forma dhe metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë: • Klasa të pajisura me kompjuterë, projektorë dhe mjete interaktive, që mundësojnë zhvillimin e mësimit modular dhe praktik; • Bibliotekë fizike dhe bibliotekë online, që sigurojnë akses të plotë në literaturën akademike dhe burimet digjitale të nevojshme për studim dhe kërkim shkencor. Këto kushte garantojnë një mjedis të favorshëm për mësimdhënie bashkëkohore, duke përforcuar autonominë intelektuale, kompetencat profesionale dhe zhvillimin kritik të studentëve, në përputhje me standardet evropiane të cilësisë në arsimin e lartë.
--	---

	Ev-27-Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies. Ev-41-Biblioteka online. Ev-42-Manual Përdoruesi Sistemi i Menaxhimit online te Bibliotekës së AFA.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni është i përkushtuar ndaj rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të personelit akademik, duke ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër, është hartuar një udhëzues strategjik që synon zhvillimin dhe aplikimin e metodave të reja, bashkëkohore dhe inovative në procesin mësimor. Ky udhëzues shoqërohet me një program të posaçëm për zhvillimin pedagogjik dhe didaktik të stafit akademik. Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ndjek një politikë të qëndrueshme dhe proaktive në mbështetje të zhvillimit profesional të personelit të saj akademik, duke nxitur ndërkombëtarizimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira arsimore dhe kërkimore. Megjithatë, vërehet se mbështetja e stafit efektiv të institucionit në përmirësimin e vazhduar apo kërkimet shkencore të ndërlidhura me fushën e këtij programi studimi, është jo e mjaftueshme. AN-4.6-Dëshmi respektimit autonomisë, lirisë akademike financiare AN-4.8-Politikia zhvillimit stafit akademik Ev-14 Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore Ev-35-Marrëveshje Erasmus dhe shkëmbime stafi.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe	Stafi përbëhet nga profesionistë të kualifikuar me tituj shkencorë dhe përvoja të spikatura si në institucione publike, ashtu edhe në sektorin privat, të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përdorimin e qasjeve bashkëkohore dhe aplikimin e praktikave reale të fushës në procesin e mësimdhënies. Ata zotërojnë njohuri të thelluara dhe kompetenca të specializuara në temat që lidhen ngushtësisht me përmbajtjen e kurrikulës, si menaxhimi i sigurisë së informacionit, mbrojtja e infrastrukturave kritike, qeverisja e riskut, siguria e rrjeteve, kriptografia dhe analiza e incidenteve kibernetike. Grupi vlerëson se ky profil i integruar akademik dhe profesional i personelit siguron një proces mësimor dinamik dhe të orientuar

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	drejt praktikës, duke u mundësuar studentëve të përvetësojnë njohuri të aplikueshme dhe aftësi që përputhen me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe standardet ndërkombëtare të fushës. Kjo përvojë shumëvjeçare i mundëson stafit akademik të sjellë në auditor situata konkrete dhe raste reale nga fusha e sigurisë kibernetike, duke i dhënë procesit mësimor një dimension praktik dhe të aplikueshëm. Kjo qasje kontribuon ndjeshëm në përvetësimin më të mirë të njohurive nga ana e studentëve dhe në përgatitjen e tyre për sfidat profesionale të kësaj fushe. Gjatë orëve të mësimit personeli akademik angazhohet në përdorimin e metodave inovative dhe bashkëkohore të mësimdhënies, me qëllim rritjen e ndërveprimit me studentët dhe konvertimin e teorisë në praktikë. Ev-27-Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni e konsideron të rëndësishëm çdo mendim dhe sugjerim të studentëve, duke i vlerësuar si pjesë përbërëse e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Këto mendime përcillen në mënyrë të strukturuar në njësinë bazë akademike përmes takimeve të drejtpërdrejta me përgjegjësin e departamentit, përfaqësuesin e studentëve në mbledhjet e departamentit, si dhe përmes komunikimeve me Dekanin, Zëvendësrektorin për procesin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor. Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për përfshirjen e zërit të studentëve është vlerësimi online i pedagogëve dhe lëndëve, ku studentët kanë mundësinë të paraqesin vërejtjet apo sugjerimet e tyre lidhur me cilësinë e procesit mësimor, përmbajtjen e kurrikulës, apo performancën e personelit akademik. Në rastet kur konstatohet se një pedagog nuk përmbush standardet e nevojshme akademike dhe profesionale, vlerësimet e studentëve mund të çojnë në masa përkatëse, përfshirë rishikimin e angazhimit të tij. Formulari i vlerësimit përmban një hapësirë të dedikuar për “komente”, ku studentët mund të shprehen lirshëm dhe në mënyrë anonime mbi çështje të ndryshme që lidhen me përvojën e tyre akademike. Të gjitha komentet dhe sugjerimet e mbledhura analizohen me kujdes nga strukturat përkatëse, dhe, në varësi të natyrës së tyre, shërbejnë si bazë për ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e aspekteve pedagogjike ose marrjen e masave korrigjuese në raste të përsëritura problematikash.

Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) zhvillohet një proces i vazhdueshëm trajnimi dhe përmirësimi profesional të personelit akademik, me fokus të veçantë në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe përdorimin e metodave inovative në përputhje me natyrën dhe fushën përkatëse të studimeve. Këto trajnime synojnë të forcojnë kompetencat pedagogjike të stafit dhe të nxisin aplikimin e metodologjive bashkëkohore, si mësimi interaktiv, përdorimi i teknologjive digjitale, dhe integrimi i qasjeve praktike në procesin mësimor. Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet përmes një mekanizmi të strukturuar institucional, në të cilin përfshihen: • Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani, të cilët realizojnë vizita në auditor për të vëzhguar procesin e mësimdhënies dhe për të plotësuar formularin e vlerësimit të performancës, në bazë të kriterëve të përcaktuara. Ky proces garanton feedback të drejtpërdrejtë dhe konstruktiv për përmirësimin e praktikave pedagogjike. • Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC), e cila përgatit raporte individuale vlerësimi për çdo lektor dhe asistent lektor, bazuar në vëzhgime, analiza dhe të dhëna nga procesi mësimor. Një element i rëndësishëm i këtij procesi është vlerësimi i dhënë nga studentët, i cili konsiderohet një instrument thelbësor për matjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe për identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim. Këto mekanizma të integruar sigurojnë një cikël të plotë të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë akademike, duke forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe zhvillimin profesional të stafit në përputhje me standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmëruar të stafit akademik.
Konkluzione	<i>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive kjo vihet</i>

	re duke qënë se një pjesë e personelit akademik vjen nga strukturat e sigurisë kibernetike në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes, ku përmendet Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike apo Agjencia e Informacionit të Sigurisë dhe Ndërlidhjes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” janë të përcaktuara qartë dhe në përputhje me kuadrin rregullativ të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA). Këto kriteret janë të integruara në dy nivele kryesore: • në Rregulloren e përgjithshme të AFA-së, e cila përcakton parimet, procedurat dhe mënyrat standarde të vlerësimit; • si dhe në syllabuset përkatëse të çdo lënde/moduli, ku pasqyrohen me detaje metodat, peshat dhe format e vlerësimit që aplikohen gjatë procesit mësimor. Studentët njihen me këto kriteret që në fillim të studimeve, gjatë javës së orientimit, ku u prezantohen procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, si dhe mënyrat e matjes së rezultateve të të nxënit. Gjithashtu, çdo syllabus përmban një rubrikë të dedikuar për mënyrën e vlerësimit, ku pedagogu: • shpjegon komponentët e vlerësimit (pjesëmarrja aktive, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare); • ofron udhëzime të qarta për kriteret e suksesit dhe mënyrën e konvertimit të pikëve në nota përfundimtare; • siguron që studentët të jenë plotësisht të informuar mbi pritshmëritë dhe standardet e performancës akademike. Rregullorja e AFA-së dhe syllabuset e lëndëve janë publike dhe të aksesueshme për të gjithë studentët, ndërsa përmbajtja e tyre shpjegohet në detaje në auditor në fillim të çdo semestri.

Vlerësimi i dijeve, paraqitet si në rregulloren e programit të studimit, ashtu edhe në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies.

Këto dy rregullore për sa i përketë këtij kriteri janë në sinkron mes tyre. Megjithatë, paraqesin një mospërputhje në sistemin e vlerësimit, si në vlerësimin me pikë, ashtu edhe në shprehjen e tyre në nota, qoftë në nota me bazë 10, ashtu edhe në vlerësim me gërma sipas sistemit anglo-sakson. Më konkretisht, neni 22, "Sistemi i Vlerësimit" në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies nuk është në përputhje me nenin 6, "Forma e studimit, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti", të rregullores së programit të studimit. Krahasimi mes këtyre dy formave paraqitet në tabelën në vijim:

Rr. Zhvillim Kurrikular			Rr. Program studimi		
Pikë	Notë	Shkronjë	Pikë	Notë	Shkronjë
96-100	10	A+	94-100	10	A
86-95	9	A	85-93	9	A-
76-85	8	B+	76-84	8	B
66-75	7	B	67-75	7	B-
56-65	6	C+	58-66	6	C
46-55	5	C	51-57	5	D
≤45	4	M	≤50	4	F
Nuk ka realizuar kredite të lëndës		P	-	-	-

Nga ku dukshëm këto dy sisteme vlerësimi nuk janë në sinkron mes tyre, si në vlerësimin me bazë 100 (pikë), ashtu edhe në ekuivalentimin e tyre me gërmë.

Ky informacion, për studentët e diplomuar, të cilët janë të pajisur me suplementin e diplomës, mund të mos jetë burim ngatërrese në rast transferimi studimesh, por për studentët që nuk janë diplomuar, dhe duan të realizojnë transferimin e studimeve nga AFA drejt një institucioni tjetër të arsimit të lartë që përdor sistemin amerikan të vlerësimit, është burim ngatërrese dhe pasaktësi në vlerësim.

Rekomandojmë hartimin e rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë mes tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit. Duke qenë se konvertimi i pikëve të vlerësimit në notë është i njëjti, në syllabuse apo rregulloren e prograzmit të studimit nuk është e nevojshme të paraqtite, është

	<i>mjaftueshëm të citohet si referencë rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies.</i> AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies Ev-22-Syllabuset e lëndëve, viti akademik 2023-2024.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se në programin e studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, procesi i informimit dhe vlerësimit të studentëve zhvillohet në mënyrë të strukturuar, transparente dhe në përputhje me parimet e sigurimit të cilësisë akademike. Në fillim të çdo lënde apo moduli, pedagogu prezanton përmbajtjen e syllabus-it, duke sqaruar në mënyrë të detajuar objektivat mësimore, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe format e vlerësimit. Ky proces garanton që studentët të jenë plotësisht të informuar për kërkesat akademike dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen gjatë gjithë semestrit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, duke kombinuar vlerësimin formatizues dhe atë përmbledhës. Kjo nënkupton se performanca e studentit monitorohet gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, në mënyrë që të vlerësohen progresi, angazhimi dhe përvetësimi gradual i njohurive. Në çdo syllabus është përfshirë një seksion specifik për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive, ku përcaktohen: • komponentët e vlerësimit (pjesëmarrja, detyrat e kursit, testet ndërmjetme dhe provimi përfundimtar); • pesha përkatëse e secilit komponent në vlerësimin total; • kriteret dhe standardet që përdoren për matjen e rezultateve të të nxënit. Ky sistem i qartë vlerësimi siguron koherencë, transparencë dhe objektivitet në matjen e arritjeve akademike të studentëve, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe motivimin për përmirësim të vazhdueshëm. Ev-22-Syllabuset e lëndëve, viti akademik 2023-2024.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive në programin Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” zhvillohet në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe praktikat bashkëkohore të vlerësimit të vazhdueshëm.

demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sistemi i vlerësimit është i ndarë në disa kategori dhe komponentë, të cilat synojnë të garantojnë një proces të drejtë, objektiv dhe gjithëpërfshirës të matjes së performancës akademike të studentit.			
	Ev-22-Syllabuset e lëndëve, viti akademik 2023-2024.			
Konkluzione	<i>Programi disponon rregullore program studimi "Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" ku tregohen procedurat e testimit dhe vlersimit të njohurive. Mënyra e vlersimit të njohurive tregohet edhe në syllabuset e lëndëve.</i> <i>Rekomandojmë hartimin e rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë me tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare në çdo lëndë është rezultat i një vlerësimi të kombinuar, i cili përfshin disa komponentë të procesit mësimor. Këta përbëhen nga vlerësimi i pjesëmarrjes aktive të studentit në seminare, laboratorë apo aktivitete praktike, si dhe ndarja e testimeve në dy faza: testi ndërmjetës, që zhvillohet pas javës së shtatë, dhe vlerësimi final, që realizohet pas javës së pesëmbëdhjetë të semestrit. Një tjetër komponent i rëndësishëm është vlerësimi i detyrës apo projektit të kursit, që kontribuon në notën përfundimtare. Forma dhe mënyra e vlerësimit për secilën lëndë përcaktohet qartë në syllabus-in përkatës, i cili u bëhet i ditur studentëve në fillim të kursit, duke garantuar transparencë dhe standardizim në procesin e vlerësimit. Ev-6-Rregullore e programit të studimit MP në "Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes". Ev-47-Rregullore e Provimeve AFA.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se procesi i vlerësimit të studentëve në programin Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” bazohet në një qasje të kombinuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila synon të matë në mënyrë të plotë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në të gjitha rastet, procesi i vlerësimit të njohurive kryhet nga dy pedagogë: njëri është titullari i lëndës, ndërsa tjetri është pedagog i së njëjtës apo i një lënde të ngjashme. Testet ndërmjetëse dhe ato përfundimtare administrohen në mënyrë të sigurt nga sekretaria mësimore, e cila kujdeset për sekretimin e tyre para provimit dhe për dekodimin pas vlerësimit, duke garantuar anonimitetin dhe objektivitetin në procesin e vlerësimit nga ana e pedagogut. Për programin e Masterit Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, vlerësimi i çdo lënde bazohet në komponentët e parashikuar në syllabus, të cilët përfshijnë: pjesëmarrjen aktive në leksione dhe seminare, vlerësimin e projektit apo detyrës së kursit, si dhe rezultatet nga testi ndërmjetës dhe ai përfundimtar. Nota përfundimtare e studentit llogaritet në bazë të një përlllogaritjeje të ponderuar të pikëve të marra nga secili komponent vlerësimi dhe më pas konvertohet në notë përfundimtare, sipas përcaktimeve të rregullores së programit. Raporti ndërmjet vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit final përcaktohet në syllabus-in e modulit përkatës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit përpara fillimit të vitit akademik.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi shoqërohet me komente për t’i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen si në detyrat e kursit apo ashtu edhe në tezat e provimit, ku ka të parashikuar seksion mbi komente të pedagogut rreth përgjigjes së studentit. Për të garantuar transparencë dhe qartësi në procesin e vlerësimit, studentëve u ofrohen seanca sqaruese, gjatë të cilave ata kanë mundësinë të shqyrtojnë në detaje mënyrën e korrigjimit dhe të marrin komente të personalizuar nga pedagogu mbi ecurinë dhe rezultatet e tyre. Provimet me shkrim zhvillohen në kushte sigurie dhe konfidencialiteti, përmes procedurës së sekretimit të testeve. Ambientet ku zhvillohen provimet janë të pajisura me mbikëqyrje

	dhe personel përgjegjës, të ngarkuar për të siguruar mbarëvajtjen e qetë dhe të rregullt të procesit provues. Gjatë korrigjimit, pedagogët përfshijnë komente shpjeguese për secilën pjesë të testit, me qëllim që studentët të kuptojnë qartë arsyetimin pas vlerësimit të marrë. Rezultatet paraprake publikohen në mënyrë të individualizuar përmes sistemit "Pitagora", duke ruajtur konfidencialitetin dhe aksesin e personalizuar për çdo student. Ev-49-Format zhvillimi detyrë kursi/ projekt Ev-50-Format Tezë provimi
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Gjatë procesit të provimeve, ambienti ku zhvillohet testimi mbikëqyret nga dy ose më shumë pedagogë, të caktuar me miratim nga Departamenti përkatës. Të gjithë mbikëqyrësit mbajnë përgjegjësi të barabartë për sigurimin e rregullit dhe korrektësisë gjatë zhvillimit të provimit. Përdorimi i telefonave celularë, si dhe i çdo materiali ndihmës apo informativ që lidhet drejtpërdrejt apo tërthorazi me lëndën, ndalohet rreptësisht. Pajisjet e tilla duhet të jenë të fikura gjatë gjithë kohëzgjatjes së testimit dhe nuk lejohet asnjë formë shfrytëzimi i tyre. Çdo tentativë për kopjim apo plagjiaturë trajtohet me seriozitet dhe ndëshkohet menjëherë me notën përfundimtare 4 (katër), pa marrë parasysh rezultatet në komponentët e tjerë të vlerësimit. Kjo masë synon të ruajë integritetin akademik dhe barazinë në procesin e vlerësimit.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	AFA sipas marrëveshjes me RASH për sistemin Pitagora (që po konfigurohet) u jepen studentëve rezultatet në mënyrë individuale, duke respektuar etikën, në seancat sqaruese përkatëse. Vlerësimi me notë në provime pasqyrohet në procesverbal, në regjistrin e vlerësimeve dhe do të pasqyrohet në regjistrin elektronik. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu dhe firmoset nga komisioni i provimit në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se dy javë nga dita e provimit. Në rast se provimi zhvillohet me gojë/me shkrim, studentët informohen për deklarinimin e notave në përfundim të provimit sipas afateve të rregullores së provimit si dhe do të hidhet në sistemin "Pitagora".
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se procesi i administrimit, publikimit dhe trajtimit të vlerësimeve të studentëve në programin

njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është i qartë, transparent dhe në përputhje me rregulloren institucionale të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA). Pas përfundimit të provimit, brenda një periudhe dyjavore, pedagogu zhvillon seanca sqaruese me studentët, të cilat shërbejnë për diskutimin dhe adresimin e çdo ankese ose paqartësie lidhur me procesin e vlerësimit. Këto seanca sigurojnë komunikim të hapur dhe respektim të etikës akademike, duke garantuar transparencë dhe drejtësi në raport me studentët. Pas përfundimit të afatit të ankesave, pedagogu regjistron rezultatet përfundimtare në sistemin elektronik “Pitagora” dhe dorëzon procesverbalin zyrtar në sekretarinë mësimore. Rezultatet u komunikohen studentëve individualisht dhe në mënyrë konfidenciale, gjatë seancave të dedikuara për sqarim, duke respektuar standardet e etikës profesionale dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultatit, sipas parashikimeve të Rregullores së institucionit dhe të programit të studimit. Ankesa i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit, i cili verifikon rastin në bashkëpunim me lektorët dhe asistentët përkatës, duke dhënë përgjigjen përfundimtare dhe të argumentuar studentit ankimues. Me kalimin e këtij afati, rezultatet marrin formë përfundimtare dhe pasqyrohen në procesverbalin zyrtar të provimit. Ky mekanizëm i qartë administrativ dhe procedural siguron integritet, transparencë dhe besueshmëri institucionale në procesin e vlerësimit dhe trajtimit të ankesave të studentëve. Ev-6-Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Siguria Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se procedura e trajtimit të ankesave të studentëve për vlerësimin e provimeve në programin Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është e qartë, e strukturuar dhe në përputhje me rregulloren e institucionit.
Konkluzione	<i>AFA parashikon në rregulloret e brendshme apo edhe në rregulloren e programit vlersim korrekt dhe transparent të</i>

	njohurive nga ana e studenteve. Gjithashtu AFA është në proces implementimi të sistemit Pitagora mundësuar nga RASH për hedhjen e notave, mungesave dhe pikëve dhe njohjen me to në kohë reale nga studentet. Rekomandohet procedure ankimi note apo provimi më të detajuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit, si në përmbajtjen e kurrikulës ashtu edhe në syllabus-et e lëndëve/modulëve të veçanta, është konceptuar për të nxitur zhvillimin e njohurive, përparimin shkencor, teknik dhe profesional të studentëve në fushën e sigurisë kibernetike dhe të informacionit.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Duke pasur parasysh natyrën specifike të programit dhe strukturën e moduleve që e përbëjnë atë, theksi vendoset në përgatitjen e studentëve me kompetenca të thelluara dhe të specializuara në fushat e teknologjisë kibernetike dhe mbrojtjes së informacionit. Në të njëjtën kohë, programi synon një formim të gjithanshëm, duke u dhënë studentëve aftësi të avancuara në të menduarit kritik, analizën dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe duke i edukuar me parimet etike dhe përgjegjshmërinë humane në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të çdo semestri, në analizën e departamentit, por edhe të fakultetit dhe të AFA analizohen dhe diskutohen me përgjegjësi niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët, sfidat për arritjen e tyre, metodat e zbatuara në mësimdhënie, aktivizimi i studentëve me synim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia zhvillohet e hapur dhe në një klimë diskutimi dhe ndërveprimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Një pjesë e konsiderueshme e seancave mësimore zhvillohen duke u mbështetur në punën në grup të studentëve me synim rritjen e ndërveprimit ndërmjet vetë studentëve dhe edukimin e punës në skuadër. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Përgjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Gjatë seancave mësimore pedagogët janë të hapur për idetë e ndryshme të studentëve në lidhje me tematika të caktuara. Ata mbështesin studentët në zhvillimin e këtyre ideve dhe në materializimin e tyre në projekte aplikative apo kërkimore.			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Pedagogë të brendshëm apo të jashtëm të programit të studimit (përzgjedhur me ekspertizë të spikatur në fusha të caktuara) përveç mësimdhënies angazhohen edhe në veprimtari të tjera, si seminare, ëorkshope, prezantime të teknologjive të ndryshme në auditorë të zgjeruara ku marrin pjesë jo vetëm studentët e programit të studimit, por edhe studentë dhe pedagogë nga programe të ndryshme studimi të fakulteteve të tjera.			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	AFA nxit dhe stimulon integrimin e personelit akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj të njohur në fushat e tyre, nëpërmjet zhvillimit të leksioneve të hapura apo trajtimit të temave specifike për zhvillimet më të reja në fusha të ndryshme.			
Konkluzione	<i>Kryesisht program garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët me synim thellimin e kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Rekomandohen më shumë orë laboratorit në syllabuse</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka një procedurë të posaçme, të parashikuar në rregulloren e tij të studimit, për studentët të cilët japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Dekani në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit organizon dhe harton procedurën për mbrojtjen e diplomave për studentët e MP “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Kjo procedurë bëhet publike për të gjithë studentët, duke përcaktuar hapat dhe ditën e vlerësimit. Departamenti kujdeset që studentët të pajisen me gjithë dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Në nivel institucional, aktet rregullatore të AFA kanë parashikuar në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit të studentëve në tërësi dhe ata të ciklit të dytë të studimeve. Edhe Rregullorja e Fakultetit shpreh qartë të gjithë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në FMS.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik i ngarkuar me zhvillimin e lëndëve përkatëse përgatit një listë të temave dhe çështjeve kryesore të secilës lëndë, me qëllim orientimin e studentëve në procesin e përgatitjes për temën e diplomës. Kjo listë, e hartuar në përputhje me përmbajtjen e programit, shpërndahet nga sekretaria mësimore për të gjithë studentët e ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Studentëve u jepet mundësia të zgjedhin vetë pedagogun udhëheqës për temën e diplomës dhe të zhvillojnë konsultime të rregullta me të, për të sqaruar paqartësitë dhe për të marrë udhëzimet e nevojshme në përputhje me temat dhe çështjet e përcaktuara më herët.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna	NA

gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Mbrojtja e diplomës në ciklin e dytë të studimeve, Master Profesional bëhet përmes mbrojtjes finale, prezantim përpara komisionit. Studentët kryejnë takime periodike me pedagogët udhëheqës e departamentit për t'u konsultuar për paqartësitë, sipas temës dhe çështjeve të shpërndara paraprakisht. Në përfundim të shkrimit të diplomës, studenti depoziton në sekretarinë mësimore kopjet me firmën e udhëheqësit si dhe kopje në format pdf. Ev-56-Rregullore e Diplomimit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët e programit Master Profesional në "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" përfundojnë ciklin e tyre të studimeve me mbrojtjen e temës së diplomës, gjatë së cilës ata vlerësohen jo vetëm për punën e kryer, por edhe për njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë gjithë vitit akademik. Gjatë këtij procesi, ata përballen me pyetje që mbulojnë aspekte të ndryshme të programeve mësimore, duke demonstruar përvetësimin e kompetencave teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtje diplome vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik përmes sekretarisë mësimore për të gjithë studentët e diplomuar. Ev-56-Rregullore e Diplomimit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sipas Rregullores së AFA studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj AFA dhe ka përmbyllur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në AFA.

zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, AFA lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave. Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, mund t'i jepet atij një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit MP "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes".			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në zyrën e arkivë-protokollit të AFA ruhet një kopje e dokumentacionit të çdo studenti për një afat të pacaktuar, në mënyrë që për çdo informacion të mëvonshëm në lidhje me studentët, të ketë dokumentacionin fizik. Mbështetur në aktet e brendshme të AFA dhe legjislacionin në fuqi dokumentacioni themelor për studentët është Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matrikullimi deri në marrjen e diplomë ose certifikatës. Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emetimin e certifikatave dhe diplomave. Ev-58-Rregullore e Sekretarisë Mësimore			
Konkluzione	<i>Në rregulloren e programit apo dhe në rregulloren diplomimit tregon që institucioni ka një politikë të qartë anagazhimi për pëmbjlljen e detyrimeve akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedis brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) zhvillon veprimtarinë e saj në një mjedis të përshtatshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm, larg zonave me ndotje mbi normat e lejuara, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë mjedisore dhe infrastrukturore. Godinat e AFA-së ndodhen në Rrugën e Dibrës, në garnizonin "Skënderbej", ku janë të vendosura edhe struktura të tjera të

	Forcave të Armatosura, duke krijuar një mjedis të kontrolluar dhe funksional për aktivitetin akademik dhe kërkimor. Institucioni plotëson normativat ligjore për sipërfaqen e shfrytëzueshme për çdo student, duke ofruar në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) një raport prej 30.3 m² për student, që tejkalon standardet minimale të kërkuara. AFA disponon mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për procesin mësimor dhe kërkimor, të pajisura me infrastrukturë moderne. Kushtet teknike të godinave janë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi: • Lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.8 m, duke siguruar ajrosje dhe ndriçim natyral optimal; • Sipërfaqja e dritareve përbën rreth 30% të sipërfaqes së dyshemesë, duke përmbushur standardet për ndriçim natyral; • Godinat janë të pajisura me sistem qendror kundër zjarrit dhe sistem mbrojtjeje nga shkarkesat atmosferike, të inspektuara periodikisht nga autoritetet përkatëse; Ekziston sistem funksional ngrohjeje e ftohjeje, gjeneratorë për furnizim alternativ me energji elektrike, si dhe depozita uji të certifikuar për furnizim të pandërprerë. Në aspektin didaktik dhe praktik, AFA siguron laboratorë të dedikuar për fushën e TIK dhe Sigurisë Kibernetike, të ndërtuar dhe pajisur sipas standardeve kombëtare për krijimin dhe funksionimin e laboratorëve universitarë. Në FMS, studentët e këtyre programeve përdorin dy laboratorë me sipërfaqe 70 m² secili, me kapacitet prej 30 vende për sallë, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për mësim praktik, trajnime dhe ushtrime laboratorike. Infrastruktura laboratorike e AFA-së përmbush plotësisht kriteret e sigurisë, funksionalitetit dhe përdorimit, dhe vlerësohet periodikisht nga autoritete të licencuara, duke garantuar një mjedis optimal për zhvillimin e mësimdhënies, kërkimit dhe trajnimit profesional. Evidenca-12-Planimetria e godinave ku zhvillohet mësimi
--	--

	Evidenca-I I-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve (2021–2025) / Tabelë përmbledhëse me të dhënat e infrastrukturës mësimore
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) siguron kushte optimale për zhvillimin e praktikave profesionale në kuadër të programit të studimit Master Profesional “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”, duke garantuar një bashkërendim të plotë midis formimit teorik dhe atij praktik. Për realizimin e praktikave, AFA vë në dispozicion sallat laboratorike të pajisura me kompjuterë dhe programe bashkëkohore, të cilat mbulojnë të gjitha nevojat teknike të procesit mësimor në fushën e sigurisë kibernetike, rrjeteve kompjuterike, kriptografisë, analizës së incidenteve dhe forenzikës dixhitale. Në mbështetje të praktikave, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) bashkëpunon ngushtë me strukturat ushtarake dhe civile të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHPFA), duke ofruar akses në ambiente, sisteme dhe ekspertizë profesionale të nivelit të lartë. Kjo ndërthurje institucionale krijon një mjedis praktik të pasur dhe realist për studentët e programit. Këto mundësi u lejojnë studentëve të: • zbatojnë në praktikë njohuritë teorike të përftuara në auditor; • zhvillojnë kompetenca profesionale dhe teknike në mjedise të simuluar ose reale pune; • dhe të përgatiten në mënyrë efektive për integrimin në tregun e punës në sektorin e sigurisë kibernetike dhe të mbrojtjes. Në përfundim, grupi vlerëson se AFA siguron kushte të favorshme dhe infrastrukturë bashkëkohore për zhvillimin e praktikave profesionale, duke forcuar komponentin praktik të programit dhe lidhjen e tij me realitetin institucional dhe profesional të fushës. Ev-40- Infrastruktura IT
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në	Praktika profesionale është pjesë e planit mësimor të zhvilluar në MP “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Në këtë mënyrë, praktika e zhvilluar gjatë periudhës së studimeve, ekuivalentohet

dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	në kredite dhe vlerësimet dokumentohen në procesverbale të firmosura nga anëtarët e komisionit të mbrojtjes së praktikës. Sipas planit mësimor, praktika profesionale për programin 'Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes' ka 6 kredite.			
Konkluzione	<i>AFA paraqet strukturë të plotë infrastrukturore IT me salla dhe laboratorë. Cdo student është i pajisur me laptop të kohës së fundit për procesin mësimor nga vetë AFA. Praktikantët mësimor kryhen në insitucione të ndryshme me profil IT nën vartësinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve	Akademia e Forcave të Armatosura zhvillon aktivitetin e saj në zbatim të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë si dhe VKM 156, datë 19.02.2020 për "Dhënie të statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare". <i>Duke qenë një institucion i organizuar me statusin e veçantë, por gjithsesi nën Ministrinë e Mbrojtjes, aktiviteti i saj gjendet i dyjzuar mes pjesës akademike dhe asaj ushtarake, si në funksionim, ashtu edhe në angazhimin e personelit akademik.</i> GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se AFA, ruan të dhëna të plota për

mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

stafin akademik si dhe atë ndihmës-akademik dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër në programin e studimit Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, bazuar edhe në formimin e tyre, si në aspektet profesionale, ashtu edhe akademike, është në përputhje me angazhimin akademik dhe lëndët përkatëse ku ata janë të angazhuar.

Duke qenë ky një master profesional, personeli akademik i angazhuar, edhe pse në disa raste është vetëm me kualifikimin “Msc”, ka një përvojë profesionale dhe ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike, ku mund të përmendim angazhimin e tyre në:

- Drejtoria e Shifrës në Ministrinë e Mbrojtjes
- Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike në Ministrinë e Mbrojtjes
- Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (AKSK)

Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë per 3 vitet e fundit akademike është si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	-	-	-	-	1	-
Dr/Phd	-	4	2	3	2	2
Msc.	-	2	1	3	1	5
Gjithsej	0	7	3	7	4	8

GVJ konstaton një tërësi dokumentesh që argumentojnë përmbushjen e kriterit, si lista e stafit akademik, CV e stafit akademik dhe ai ndihmës akademik, dosje personeli efektiv dhe me kontratë etj., të cilat disponohen nga departamenti përgjegjës, Departamenti i Teknologjise së Informacionit si dhe zyra e burimeve njerëzore në institucion. GVJ evidenton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka nivelin e duhur të formimit në fushën e programi të studimit. Megjithatë jo i gjithë personeli i angazhuar nga tituj/grada shkencore.

	AN-4.9-Struktura organizative AFA AN-4.9.1-Struktura organizative Programit AN-4.8-Politikia zhvillimit stafit akademik AN-4.7.2-Strategjia menaxhimit burimeve njerëzore Ev-21-Praktika e plotë për miratimin e pedagogëve të jashtëm Ev-37-Procedurë punësimi staf me kohë të plot-pjesëshe Ev-53-Urdhër i MM për politikën dhe procedurat e rekrutimit të oficerëve të rinj Ev-35-Marrëveshje ERASMUS dhe Shkëmbime stafi Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparlajmëruar të stafit Akademik Ev-60-CV të Personelit Akademik Ev-14-Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, për mënyrën se si AFA është e organizuar, me statusin e saj të veçantë, brenda Ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen, paraqet një veçori në klasifikimin formal të personelit akademik të angazhuar. <i>Në këtë program studimi angazhohet personel i ministrisë së mbrojtjes, por që për çështje të ndarjes administrative të statuseve të ministrisë dhe asaj të AFA, ky personel quhet si jo efektiv, edhe pse realisht është i punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes.</i> Kjo vërehet edhe në plotësimin e tabelave 6.1, 6.2 dhe 6.3 në RVB, ku është paraqitur si PAK, personel i Ministrisë së Mbrojtjes. AN-4.9.1-Struktura organizative Programit Ev-60-CV të Personelit Akademik Ev-14-Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore Ev-10-Programi Mësimor MP Siguria Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar tabelave të plotësuara personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike, 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024, vërehet se ka një qëndrueshmëri stafit, përfshirë edhe ata PAK. Duke qenë ky një master profesional, personeli akademik i angazhuar, edhe pse në disa raste është vetëm me kualifikimin “Msc”, ka një përvojë profesionale dhe ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike, ku mund të përmendim angazhimin e tyre në: • Drejtoria e Shifrës në Ministrinë e Mbrojtjes • Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike në Ministrinë e Mbrojtjes • Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (AKSK)

	Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike AN-4.9.1-Struktura organizative Programit Ev-60-CV të Personelit Akademik Ev-14-Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore Ev-10-Programi Mësimor MP Siguria Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve https://afa.mil.al/images/vendimeSA/Vendimi_nr90.pdf
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni, përtej plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, është edhe pjesë e formave të armatosura, dhe si e tillë, ndjek procedura të mirëpërcaktuara për rekrutimin e personelit si akademik, ashtu edhe administrativ. Për këtë program studimi, procedura e rekrutimit është transparente, dhe rezultatet e rekrutimit janë publike si vendime të senatit akademik, ku një shembull për rekrutimin e personelit për vitin akademik 2023-2024 gjendet në: https://afa.mil.al/images/vendimeSA/Vendimi_nr90.pdf N-4.8-Politikia zhvillimit stafit akademik AN-4.7.2-Strategjia menaxhimit burimeve njerëzore Ev-21-Praktika e plotë për miratimin e pedagogëve të jashtëm Ev-37-Procedurë punësimi staf me kohë të plot-pjesëshme Ev-53-Urdher i MM për politikën dhe procedurat e rekrutimit të oficerëve të rinj Ev-35-Marrëveshje ERASMUS dhe Shkëmbime stafi Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmëruar të stafit Akademik Ev-60-CV të Personelit Akademik Ev-14-Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në Zhvillimin e këtij programi studimi, nuk është angazhuar asnjë personel ndihmës akademik. Edhe në zhvillimin e aktiviteteve laboratorike, të nevojshëm për përcimin e dijeve, ato kanë qenë të gërrshetura me pjesën e seminareve dhe leksioneve, dhe si të tilla janë ndjekur nga pedagogu i lëndës. Kjo ka qenë e mundur duke parë edhe numrin e ulët të studentëve në këtë program, të cilët për vite kanë qenë: • 2021-2022, 15 student • 2022-2023, 19 student • 2023-2024, 23 student Megjithatë, rekomandohet, që nëse do të ketë rritje të numrit të studentëve, angazhimi i një personeli ndihmës akademik, do të

	ishite plotësues dhe ndihmës për zhvillimin e aktiviteteve laboratorike. Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike AN-4.9.1-Struktura organizative Programit Ev-60-CV të Personelit Akademik Ev-10-Programi Mësimor MP Siguria Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni, duke patur një status të vecant ligjor, përmbush detyrimet në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë, por edhe të gjitha detyrimet ligjore që janë specifike e forcave të armatosura. Kështu, zyra e burimeve njerëzore/DAK administron të gjithë procesin dhe dokumentimin e personelit akademik, administrativ dhe ushtarak të angazhuar në këtë program studimi. Gjithashtu administron edhe evidentimin e zhvillimit të aktiviteteve didaktike nga personeli përkatës. Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike AN-4.9.1-Struktura organizative Programit Ev-60-CV të Personelit Akademik Ev-14-Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore Ev-10-Programi Mësimor MP Siguria Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-30-Praktika e DTI me kriteret për vendet vakante
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	AFA ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione që kanë në fokus sigurinë kibernetike, sikurse është Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (AKSK), Drejtoria e Shifrës në Ministrinë e Mbrojtes, Qendra e Inovacionet të Sigurisë dhe Mbrojtjes, apo edhe kompani që operojnë në tregun e teknologjisë së informacionit. Për zhvillimin me efikasitet të praktikës profesionale, institucioni ka hartuar edhe udhëzues specifik, i cili ndihmon studentin në përgatitjen e tij dhe më pas në raportimin e praktikës pranë AFA dhe vlerësimin e tij përfundimtar me notë. Ev-20-Institucionet me të cilat zhvillohet praktika profesionale AN-4.22.1-Marrëveshje Bashkëpunimi AN-4.22-Politika të bashkëpunimit Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës Ev-65-Dosje për Praktikën Mësimore Ev-66-Formular Vlerësimi nga Institucioni Pritës ku kryhet praktika profesionale

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Subjekti pritës, për praktikën profesionale të studentit, përcakton një person përgjegjës i cili duhet të udhëzojë studentin në të gjitha detyrat që ai duhet të kryejë. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit relacionin e praktikës, të cilën më pas e prezanton para komisionit të ngritur në nivel departamenti. Pas përfundimit të praktikës, studenti dorëzon relacionin e praktikës shoqëruar me një formular vlerësimi për të të bërë nga subjekti në të cilën është kryer praktika profesionale. Ev-20-Institucionet me të cilat zhvillohet praktika profesionale AN-4.22.1-Marrëveshje Bashkëpunimi AN-4.22-Politika të bashkëpunimit Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës Ev-65-Dosje për Praktikën Mësimore Ev-66-Formular Vlerësimi nga Institucioni Pritës ku kryhet praktika profesionale			
Konkluzione	<i>Institucioni ka të angazhuar në këtë program studimi, staf akademik në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, plotëson kriteret ligjore si për numër stafi, ashtu edhe për kualifikimet e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se AFA disponon mjediset të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në auditor. Referuar të dhënave për infrastrukturën në funksion AFA rezulton se mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme duke qenë se në mundësohet mbi 30 m ² /studen. Në total për AFA sallat e leksioneve janë 2, me një sipërfaqe totale të tyre 144 m ² ndërsa salla seminaresh janë gjithsej 9 me sipërfaqe totale 447 m ² . Në ambient disponohet një sallë për

aktivitete promovuese me sipërfaqe 800 m², laborator informatike me sipërfaqe 39 m², Sallë për bibliotekë me sipërfaqe 331 m², etj..

Nga ana tjetër, baza laboratorike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi.

AFA, në kuadër të modernizimit të bazës laboratorike, jo vetëm në shërbim të këtij programi studimi, por aftësimin në teknologji informacioni dhe në veçanti në siguri kibernetike, është pajisur me bazë moderne kompjuterike, e cila përfshinë:

Nr.	Emërtim	Sasi (copë)
1.	Laptop advanced	190
2.	Kompjuter desktop 2	64
3.	Videoprojektor tip 2	24
4.	Printer all in one	5
5.	Fotokopje multifunction high volume	6
6.	Skaner tip 4	1
7.	Fotokopje multifunksionale BË A3	1
8.	UPS 1000 VA	3
9.	Video projektor tip 1	1
10.	Tabelë interaktive 85"	15
11.	Akses Point (long range)	9
12.	Sistem i plotë audio	5
13.	Televizor 55"	4
14.	Televizor 110"	1
15.	Router Cisco	9
16.	Sëitch Cisco DNA	9
17.	Cisco Ëireless router	3
18.	Cisco fireëall	3
19.	Akesorë të ndryshëm për vënien në punë të kësaj infrastrukture	-

Për një total prej 86,763,997 Lekë me TVSH.

Gajtë vizitës në institucion u vizituan ambientet ku këto pajisje janë instaluar, dhe sidomos, laptop advanced u janë dhënë në përdorim studentëve të kësaj akademie për aftësimin e tyre në fushën e sigurisë kibernetike.

	Studentët e këtij progreami studimi kanë akses në infrastrukturën fikse (kompjuter desktop), si ato të AFA, ashtu edhe ato të Qendrës së Inovacionit dhe të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-38-Të dhëna mbi infrastrukturën Ev-40-Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve Ev-68-Manual Përdorimi të Google Classroom Ev-73-Prokurimi Paisje IT sipas Marrëveshjes me AKSHI
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	AFA ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedise, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion GJV pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, video projektor, si mundësi aksesimi të internetit (lidhje wireless), etj. Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-27-Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies Ev-38-Të dhëna mbi infrastrukturën Ev-40-Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve Ev-68-Manual Përdorimi të Google Classroom Ev-73-Prokurimi Paisje IT sipas Marrëveshjes me AKSHI
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të	Për programin e studimit Master Profesional "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes" realizimi i seancave të ushtrimeve, seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. GJV konstatoi se nga ana e institucionit në përgjithësi i është kushtuar një vëmendje e veçantë pajisjes me infrastrukturën e duhur informatike në mbështetje të aktiviteteve akademike që AFA dhe Qendra e Inovacionit të

moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Sigurisë dhe Mbrojtjes ofrojnë për aftësimin e personelit të ministrisë së mbrojtjes dhe studentëve që ndjekin programet e studimit në AFA. GVJ, gjatë vizitës së ambienteve, pati rastin të njihet me karakteristikat e harduerit si dhe të programeve të karakterit të përgjithshëm dhe profesional të pranishëm në laboratorët përkatës. GVJ është i mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivat formues të programit të studimit në tërësi. Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-38-Të dhëna mbi infrastrukturën Ev-40-Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve Ev-73-Prokurimi Paisje IT sipas Marrëveshjes me AKSHI
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-38-Të dhëna mbi infrastrukturën Ev-40-Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024. Ev-73-Prokurimi Paisje IT sipas Marrëveshjes me AKSHI
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	AFA ka nënshkruar disa marrëveshje me institucione shtetërore dhe private për mundësimin e zhvillimit të praktikave profesionale për studentët, jo vetëm të këtij programi studimi. Për specifikat e këtij programi studimit, me rëndësi janë bashkëpunimet me: • Drejtoria e Shifrës në Ministrinë e Mbrojtjes • Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike në Ministrinë e Mbrojtjes • Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (AKSK) Gjithashtu, studentët e këtij programi studimi kanë zhvilluar praktikat profesionale në institucione të tjera si: • Agjencia e mbrojtjes së të drejtës së autorit

Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	• Vodafone Albania sha • Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit • Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit • Advanced Business Silution • Spitali Universitar i Traumës • Smart Social • Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan • Etj. Ev-20-Institucionet me të cilat zhvillohet praktika profesionale AN-4.22.1-Marrëveshje Bashkëpunimi AN-4.22-Politika të bashkëpunimit Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës Ev-65-Dosje për Praktikën Mësimore Ev-66-Formular Vleresimi nga Institucioni Pritës ku kryhet praktika profesionale			
Konkluzione	<i>Institucioni ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedise, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe nga vizita në Institucion, nga takimet me stafin akademik si edhe vizita në ambientet e Bibliotekës Shkencore të AFA, evidenton se literatura bazë dhe ajo ndihmëse e përdorur është literaturë e viteve të fundit dhe që garanton përcjelljen në mënyrë efektive të dijeve dhe njohurive tek studentët e këtij programi studimi. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve https://www.afa.mil.al/rreth-kds/biblioteka

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, në fillim të çdo viti akademik, depoziton në njësinë bazë e më pas në bibliotekën e AFA, të gjitha materialet e lëndës të tilla si: libra, monografi, leksione të shkruara etj. Gjithashtu në përfundim të çdo viti akademik, në nivel departamenti bëhet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore ku evidenton arritjet por edhe problematikat. Ndër to në formë tabelare specifikohen të dhënat për literaturën për secilin modul dhe pedagog. Mangësi të cilat shtrohen më pas për vendimmarrje dhe prokurim. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se AFA zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu edhe AFA ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online. Në ambientet e bibliotekës fizike ka vende të mjaftueshme për shfrytëzim të literaturës apo huazimin e saj. Biblioteka është e hapur në orarin 08:00 – 21:00. Për natyrën ushtarake të fokusit të AFA në tërësinë e saj, edhe biblioteka paraqet këtë qasje, ku gjendet një literaturë e zgjeruar e doktrinës ushtarake. Në bibliotekë gjenden edhe punimet doktorale të mbrojtur pranë AFA që prej vitit 1980. Gjithashtu, për të garantuar një qasje në materiale të përditësuara, AFA ka qasje në platforma online si EBSCO. Megjithatë, për natyrën ushtarake të AFA dhe të Mnistrisë së Mbrojtjes, rrjeti i brendshëm i bibliotekës është i mbyllur për arsye sigurie. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista	AFA ofron për studentët një bibliotekë shumë të pasur me literaturë specifike për fushën ushtarake, por edhe një literaturë të përgjithshme dhe teknike. Biblioteka e AFA disponon 9467 tituj fizikë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. AFA disponon një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese që mbështet procesin akademik. Tekstet

shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	mësimore të përdorura nga studentët e FMS janë të miratuara nga Senati Akademik dhe janë të harmonizuara me programet e institucioneve partnere në NATO. Biblioteka përtej vendeve të leximit klasike, është e pajisur me 30 njësi desktop të cilët mundësojnë konsultimin e literaturës elektronike të bibliotekës apo përdorimin e tyre për hartimin e punimeve të diplomave, detyrave/projekteve të kursit. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve https://www.afa.mil.al/rreth-kds/biblioteka
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Qasja në bibliotekën e AFA është pa pagesë dhe e hapur si për studentët ashtu edhe për të gjithë stafin në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve https://www.afa.mil.al/rreth-kds/biblioteka
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka përtej vendeve të leximit klasike, është e pajisur me 30 njësi desktop të cilët mundësojnë konsultimin e literaturës elektronike të bibliotekës apo përdorimin e tyre për hartimin e punimeve të diplomave, detyrave/projekteve të kursit. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve https://www.afa.mil.al/rreth-kds/biblioteka
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është e hapur në orarin 08:00 – 21:00. Orar që përkon me zhvillimin e aktiviteteve didaktike për programe studimi që zhvillohen në AFA. Gjithashtu, biblioteka është e hapur edhe për rekrutët e rinj të forcave të armatosura, të cilët jetojnë në ambientet konviktores në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve https://www.afa.mil.al/rreth-kds/biblioteka
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të	Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga njësia bazë,

programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	miratuar në atë kryesore, dhe më pas, miratohet në bordin e administrimit për efektet financiare që paraqet. Biblioteka pasurohet në mënyrë periodike me literaturë të azhurnuar, sipas nevojave të programeve të studimit që ofrohen në tërësi në AFA. Ev-41-Biblioteka online Ev-57-Të dhëna mbi bibliotekën e AFA Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve https://www.afa.mil.al/rreth-kds/biblioteka			
Konkluzione	<i>AFA zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Biblioteka përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në AFA garantohet nga Rregulloret përkatëse. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër Regjistrin të arritjeve akademike dhe Regjistrin të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar

	nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA. Gjithashtu, sekretaria mësimore nëpërmjet platformës Pitagora aktualisht, administron të gjithë informacionin e studentit nga regjistrimi i tij e deri në përfundim të studimeve, për detyrimet e lëndëve, vlerësimin etj. Ev-58-Rregullore e Sekretarisë Mësimore AN-4.1 Rregullore e njesise kryesore AN-4.1.1 Rregullore e departamentit Ev-18-Shembuj të përdorimit të sistemit të brendshëm SHARE FOLDER
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion sikurse edhe nga takimi që pati në institucion, evidentoi se Institucioni mban të dhënë të cilat rinovohen çdo vit në lidhje me stafin akademik, ndihmës akademik sikurse edhe atë administrativ apo edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni ka me partner të ndryshëm për mbarrëvajtjen e programit të studimit. Sistemi informatik i menaxhimit të burimeve njerëzore, përtej qasjes që ka personeli administrativ i AFA, është në përdorim me privilegje aksesit edhe për personelin administrativ në tërësi të njësive të Ministrisë së Mbrojtjes. Ev-58-Rregullore e Sekretarisë Mësimore AN-4.1 Rregullore e njesise kryesore AN-4.1.1 Rregullore e departamentit Ev-18-Shembuj të përdorimit të sistemit të brendshëm SHARE FOLDER
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Për natyrën ushtarake, dhe sigurinë e informacionit të kërkuar për këtë karakteristikë, AFA, për ndërveprimin me studentët, përdor një rrjet të pa klasifikuar dhe me qasje në platformën PITAGORA të dakordësuar me marrëveshje përkatëse me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH). Në këtë platformë kanë akses si stafi akademik, ai administrativ dhe qithashtu edhe studentët. Gjithashtu, stafi akademik përdor edhe platformën Google Classroom për komunikimin interaktiv me studentët e këtij programi studimi. Ev-18-Shembuj të përdorimit të sistemit të brendshëm SHARE FOLDER Ev-68-Manual Përdorimi të Google Classroom Ev-69-Marrëveshje e Univeritetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma Pitagora ka module informuese për studentët ku ata informohen rreth avancimit të tyre akademik. Përdorimi i platformës Google Classroom, lejon një interaktivitet më të lartë mes studentëve dhe personelit akademik, duke mundësuar edhe shkëmbimin e materialeve didaktike, projekteve/detyrave të kursit, etj. Ev-68-Manual Përdorimi të Google Classroom Ev-69-Marrëveshje e Univeritetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Institucioni, përtej platformave të brendshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, ka platformën Pitagora në bashkëpunim me RASH si dhe Google Classroom. Platforma që kanë mundësi raportimesh të ndryshme statistikore. Ev-68-Manual Përdorimi të Google Classroom Ev-69-Marrëveshje e Univeritetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të AFA, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit. Në faqen ëeb jepet informacion dhe për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj. GVJ eksploroji mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë. Ky informacion gjendet si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master
Konkluzione	<i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Informacioni në lidhje me stafin akademik PAE, PAK dhe ndihmës akademik mbahet nga Zyra e burimeve njerëzore dhe menaxhohen me sistemin e brendshëm elektronik për burimet njerëzore.</i> Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren

	<i>nëpërmjet faqes elektronike të AFA, të cilat rezultojnë të përditësuara dhe në dy gjuhë.</i> <i>Të dhënat për të gjithë studentët e AFA menaxhohen në sistemin online Pitagora</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel institucioni mbulohet nga bordi i administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin akademik dhe Rektorin e AFA. GVJ konstatoi se nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të AFA, statusin e veçantë të saj dhe mbështetjen financiare nga Ministria e Mbrojtjes, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi. AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Ev-9-Tabelë me të dhënat Përmbledhëse Ev-29-Shembuj të Buxheteve Vjetore të AFA - Vitet akademike Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve Tabela me Aneksat Master-Profesional Siguri Kibernetike

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në statutin e Akademisë së Forcave të Armatosura përcaktohet qartë se financimi realizohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjal administrativ i AFA-së i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e AFA-së. Me propozim të Senatit Akademik ai informohet rreth buxhetit, pasi miratimi i tij realizohet nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Ministri i Mbrojtjes. Statuti i AFA dhe rregulloret e brendshme të saj, përshkruajnë proceset e propozimit të nevojave të buxhetit, miratimit të tyre në nivele njësie bazë dhe atë kryesore, e më pas miratimi në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes. Ev-1 Statuti i AFA AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët AN-4.6-Dëshmi respektimit autonomisë, lirisë akademike financiare Ev-9-Tabelë me të dhënat Përmbledhëse Ev-29-Shembuj të Buxheteve Vjetore të AFA - Vitet akademike Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Akademia e Forcave të Armatosura, duke qenë në varësi financiare të Ministrisë së Mbrojtjes, i nënshtrohet të njëjtave procese audituese si të gjitha institucionet e varësisë. AFA është objekti i auditimit ligjor të pasqyrave financiare, auditimi i cili realizohet nga Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Mbrojtjes. Pasqyrat e audituara financiare janë publike sipas përcaktimeve ligjore për Kontabilitetin dhe për QKB. Raporti i auditit depozitohet në QKB sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Ev-9-Tabelë me të dhënat Përmbledhëse Ev-29-Shembuj të Buxheteve Vjetore të AFA - Vitet akademike Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Buxheti i institucionit hartohet dhe miratohet sipas procedurave të përcaktuara në Statutin e AFA dhe Rregulloren e brendshme të saj. Sipas këtyre procedurave, në përgatitjen e buxhetit vjetor të institucionit përfshihen Administratori dhe Zyra e Financës, duke marrë në konsideratë kërkesat e njësisë kryesore dhe bazë. Buxheti i akorduar është i detajuar në zëra specifike dhe zbatimi i tij mbikëqyret nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve mbështetëse,

	në bashkëpunim me organet drejtuese si dhe raportohet në përfundim të viti nga strukturat përgjegjëse në të gjitha njësitë bazë/kryesore të AFA. Projektbuxheti pasqyron politikat e zhvillimit të institucionit dhe synon përmbushjen e kërkesave të veprimtarisë, që kryesisht kanë të bëjnë me logjistikën e mësimdhënies, personelin akademik, veprimtarinë shkencore të planifikuar përgjatë vitit akademik, pasurimin e bibliotekës së institucionit, etj. AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Ev-9-Tabelë me të dhënat Përmbledhëse Ev-29-Shembuj të Buxheteve Vjetore të AFA - Vitet akademike Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	AFA, si një njësi që financohet nga buxheti i shtetit, dhe në veçanti nga ai i Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe takimet e kryera gjatë vizitës, i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit. AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Ev-9-Tabelë me të dhënat Përmbledhëse Ev-29-Shembuj të Buxheteve Vjetore të AFA - Vitet akademike Ev-59-Vendim SA & BA për miratimin e planit të blerjes së librave të rinj dhe botimeve Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike			
Konkluzione	<i>AFA dhe vetë programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi i studimit të ciklit të dytë “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” është ndërtuar referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e organizuar në 60 kredite dhe me kohëzgjatje normale në një vit akademik. AFA ka institucionalizuar të gjithë procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në programin Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”. Këto procedura janë të shprehur qartë në Statut të AFA-së dhe rregulloret e saj. Rregullore të cilët përshkruajnë procesin e regjistrimit të studentëve, të zhvillimit të procesit mësimor, të transferimit, procedurën e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve të MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019. AN-4.18-19-Politika e pranimit dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët AN-4.2-Dosja Programit Studimit AN-4.5-Strategjia e zhvillimit të programit MPCs
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Veprimtaria mësimore në programin e studimit, Master Profesional në “Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes” zhvillohet në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, në Fakultetin e Mbrojtjes dhe i Sigurisë (FMS), është e kontrolluar dhe monitoruar nga strukturat kolegjiale dhe akademike në nivel institucioni dhe e mbështetur nga strukturat ndihmës-akademike dhe administrative. GVJ konstaton zbatimin me rigorozitet të procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Dokumentet institucionale përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos cënuar aspak lirinë përkatëse të tyre. Procedura që monitorohen në zbatimin e tyre edhe nga njësi përkatëse e sigurimit të cilësisë. AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.11-Politika për të mësuarin-mësimdhënien AN-4.11.1-Rregullore NJSBC

	AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies AN-4.15-Procedurë ankimimi për studentët AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësise së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies AN-4.18-19-Politika e pranimi dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimi dhe procedurën për t'u ndjekur, jepen në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Rregulloren e Programit të studimit, dhe në veçanti: Në programin e ciklit të dytë të studimit "Master Profesional" në "Siguri Kibernetike" kanë të drejtë të aplikojnë, shtetasit shqiptarë të cilët: - Vërtetojnë se zotërojnë një diplomë të Ciklit të Parë "Bachelor", në të gjitha programet e ofruara nga Shkencat Kompjuterike, Inxhinierike dhe të specialitetit të ndërlidhjes së bashku me certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose zotërojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, vlerësuar ekuivalente me të nga MASR si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e studimeve të Ciklit të Dytë ose të Tretë në fushën e Tëknologjise së Informacionit, Inxhinierisc. - Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga MASR). - Janë personel ushtarak dhe civil në forcat e Armatosura të RSH dhe vendeve të tjera brenda NATO, bazuar në marrëveshjet në fuqi dypalëshe të Ministrisë të Mbrojtjes. - Janë personel civil apo në uniforme nga institucione të tjera përgjegjëse për sigurinë kombëtare bazuar në legjislationin në fuqi. - Plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe kriteret e përcaktuara dhe të miratuara nga institucioni. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Komisioni i Përzgjedhjes ngritur nga Dekanati i FMS. Komisioni ka në përbërjen e tij të paktën 5 anëtarë, nga të cilët njëri është përfaqësues i Rektoratit. Vlerësimi i kandidatëve bëhet mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikanti si dhe nëpërmjet intervistës, sipas kritereve

	ligjore dhe kriterëve shtesë të miratuara nga Dekanati dhe Senati Akademik, bazuar në propozimin e Departamentit të Strategjise Studimeve të Avancuara, dhe Historise, përgjegjes për programin e studimit. AN-4.3-Rregullore Programit Studimit https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master																				
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik. Kriteret që bëhen publike edhe në faqen e internetit të AFA. Elementë më të detajuar lidhur me pranimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit (Neni 5 – Kushtet/Kriteret e pranimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit në programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional në Siguri Kibernetike”). Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Komisioni i Përzgjedhjes ngritur nga Dekanati i FMS. Komisioni ka në përberjen e tij të paktën 5 antare, nga të cilët njeri është përfaqësues i Rektoratit. Vlerësimi i kandidatëve bëhet mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikanti si dhe nëpërmjet intervistës, sipas kriterëve ligjore dhe kriterëve shtesë të miratuara nga Dekanati dhe Senati Akademik, bazuar në propozimin e Departamentit të Strategjise Studimeve të Avancuara, dhe Historise, përgjegjes për programin e studimit. Referuar tabelës së mëposhtme, në tre vitet e pasqyruar, në këtë program studimi nuk ka patur transferime dhe në total për këto vite, kanë qenë 32 student. <table><tr><th colspan="4">Master i Profesional në "Siguri Kibernetike"</th></tr><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th><th>Studentë të transferuar sipas viteve</th><th>Totali</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>15</td><td>-</td><td>15</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>19</td><td>-</td><td>19</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>23</td><td>-</td><td>23</td></tr></table> AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.11-Politika për të mësuarin-mësimdhënien AN-4.15-Procedurë ankimimi për studentët AN-4.18-19-Politika e pranimit dhe regjistrimit të studentëve	Master i Profesional në "Siguri Kibernetike"				Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali	2021-2022	15	-	15	2022-2023	19	-	19	2023-2024	23	-	23
Master i Profesional në "Siguri Kibernetike"																					
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali																		
2021-2022	15	-	15																		
2022-2023	19	-	19																		
2023-2024	23	-	23																		

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen ueb përpara fillimit të vitit akademik. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi në programin e studimit Master Profesional në Siguri Kibernetike. Gjithashtu, institucioni merr në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, organizojnë aktivitete informuese për rekrutimin e personelit në Forcat e Armatosura, ku pjesë e këtij informacioni është edhe oferta akademike e këtij institucioni. Në nivel institucional funksionon Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), e cila mundëson përmes sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Promovimin, njohjen dhe orientimin e studentëve me programet e studimit dhe këshillimin e karrierës. Institucioni në tërësinë e tij, ka përdorur gjerësisht kanale të ndryshme informimi, sikurse janë rrjetet sociale, hapësira kohore në televizionet kombëtare dhe stendat informuese në tërësi për Forcat e Armatosura. AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.18-19-Politika e pranimi dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Për këtë program studimi, institucioni publikon në faqen ëeb, të dhëna të dobishme për informimin e kandidatëve. Gjithashtu, në nivel institucional funksionon Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), e cila mundëson përmes sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Promovimin, njohjen dhe orientimin e studentëve me programet e studimit dhe këshillimin e karrierës.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.18-19-Politika e pranimi dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	AFA mirëpret studentët e rinj në auditore dhe stimulon afrimin e tyre pranë institucionit, nëpërmjet politikave të ndryshme të pranimi që zbaton, aplikon zbritje në masën 50% të tarifës të studimit për studentt që vijnë nga rradhët e Forcave të Armatosura ose nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes. AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.18-19-Politika e pranimi dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit Master Profesional në "Siguri Kibernetike" pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e AFA dhe Rregulloren e programit të studimit..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Programi i studimit Master Profesional në "Siguri Kibernetike" realizohet me 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 1 vit. Studimet e këtij programi përmbyllen me punim diplome. Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të AFA. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve gjenden në rregulloret përkatëse. Informacion që gjendet edhe në faqen ëeb zyrtare të institucionit, dhe gjithashtu bëhet i njohur edhe nëpërmjet takimeve që realizohen nga Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), e cila mundëson përmes sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Promovimin, njohjen dhe orientimin e studentëve me programet e studimit dhe këshillimin e karrierës.

	AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies AN-4.12-Politika të vlerësimit akademik AN-4.13-Rregullore për testimet, provimet, procedurat e diplomimit AN-4.18-19-Politika e pranimit dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e programit të studimit është burimi kryesor i informimit të studentëve në lidhje me procedurat, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga të qenurit student i këtij programi studimi. Megjithatë, në rregulloren e programit të studimit nuk ka informacione rreth procedurave për njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Ky informacion gjendet në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, përkatësisht në Kreun IV të saj, Njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve. AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies AN-4.12-Politika të vlerësimit akademik AN-4.13-Rregullore për testimet, provimet, procedurat e diplomimit AN-4.18-19-Politika e pranimit dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Vlerësimi i dijeve, paraqitet si në rregulloren e programit të studimit, ashtu edhe në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies. Këto dy rregullore për sa i përket këtij kriteri janë në sinkron mes tyre. Megjithatë, paraqesin një mospërputhje në sistemin e vlerësimit, si në vlerësimin me pikë, ashtu edhe në shprehjen e tyre në nota, qoftë në nota me bazë 10, ashtu edhe në vlerësim me gërma sipas sistemit anglo-sakson. Më konkretisht, neni 22, "Sistemi i Vlerësimit" në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies nuk është në përputhje me nenin 6, "Forma e studimit, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti", të rregullores së programit të studimit.

Mënyra e vlerësimit në pikë, gërma dhe notë, është në përputhje me Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies si dhe suplementit të diplomës.

Krahasimi mes këtyre dy formave paraqitet në tabelën në vijim:

Rr. Zhvillim Kurrikular Si dhe Suplementi i diplomës			Rr. Program studimi		
Pikë	Notë	Shkronjë	Pikë	Notë	Shkronjë
96-100	10	A+	94-100	10	A
86-95	9	A	85-93	9	A-
76-85	8	B+	76-84	8	B
66-75	7	B	67-75	7	B-
56-65	6	C+	58-66	6	C
46-55	5	C	51-57	5	D
≤45	4	M	≤50	4	F
Nuk ka realizuar kredite të lëndës		P	-	-	-

Nga ku dukshëm këto dy sisteme vlerësimi nuk janë në sinkron me tyre, si në vlerësimin me bazë 100 (pikë), ashtu edhe në ekuivalentimin e tyre me gërma.

Ky informacion, për studentët e diplomuar, të cilët janë të pajisur me suplementin e diplomës, mund të mos jetë burim ngatërrese në rast transferimi studimesh, por për studentët që nuk janë diplomuar, dhe duan të realizojnë transferimin e studimeve nga AFA drejt një institucioni tjetër të arsimit të lartë që përdor sistemin amerikan të vlerësimit, është burim ngatërrese dhe pasaktësi në vlerësim.

Rekomandojmë hartimin e rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë me tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit. Duke qenë se konvertimi i pikëve të vlerësimit në notë është i njëjti, në syllabuse apo rregulloren e prograzit të studimit nuk është e nevojshme të paraqitet, është mjaftueshëm të citohet si referencë rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies

AN-4.3-Rregullore Programit Studimit

AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies

AN-4.12-Politika të vlerësimit akademik

	AN-4.13-Rregullore për testimet, provimet, procedurat e diplomimit Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës AN-4.18-19-Politika e pranimi dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Master Profesional në “Siguri Kibernetike”. Në planin mësimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 8 kredite ECTS ($\approx 13\%$). Për realizimin e temës së diplomës studentët bazohen në rregulloren e programit të studimit dhe udhëzimet e hartuara nga institucioni. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template. AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies AN-4.12-Politika të vlerësimit akademik AN-4.13-Rregullore për testimet, provimet, procedurat e diplomimit Ev-49-Format Zhvillimi Detyrë Kursi Ev-50-Format Teze Provimi
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen ueb përpara fillimit të vitit akademik. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi në programin e studimit Master Profesional në Siguri Kibernetike. Gjithashtu, institucioni merr në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, organizojnë aktivitete informuese për rekrutimin e personelit në Forcat e Armatosura, ku pjesë e këtij informacioni është edhe oferta akademike e këtij institucioni. Në nivel institucional funksionon Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), e cila mundëson përmes sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Promovimin, njohjen dhe orientimin e studentëve me programet e studimit dhe këshillimin e karrierës.

	Institucioni në tërësinë e tij, ka përdorur gjerësisht kanale të ndryshme informimi, sikurse janë rrjetet sociale, hapësira kohore në televizionet kombëtare dhe stendat informuese në tërësi për Forcat e Armatosura. AN-4.18-19-Politika e pranimit dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/cikli-i-pare-bachelor https://www.afa.mil.al/cikli-i-dyte-master			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar rregollore të brendshme që trajtojnë të gjitha aspektet e mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve.</i> <i>Institucioni të rishikojë dhe uniformojë tabelat vlerësuese të dijeve/njohurive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, mbrojtje diplomash dhe praktikash mësimore etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të AFA. Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programet e studimit/lëndët përkatëse. AN-4.1 Rregullore e njesise kryesore AN-4.1.1 Rregullore e departamentit AN-4.2-Dosja Programit Studimit

	AN-4.2.1-Diploma Suplementi AN-4.2.2-Syllabuse MP CS AN-4.3-Rregullore Programit Studimit
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GJV u informua se AFA shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit ku pasqyrohen Rregulloret dhe Statuti i institucionit si dhe një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Syllabuset që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë. AN-4.3-Rregullore Programit Studimit AN-4.13-Rregullore për testimet, provimet, procedurat e diplomimit Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës Ev-48-Manual për përdorimin e Share AFA Ev-49-Format Zhvillimi Detyrë Kursi Ev-50-Format Teze Provimi
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Punësimi për studentët të cilët përfundojnë studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura është i garantuar nga ana e Forcave të Armatosura nëpërmjet politikave të saj të rekrutimit dhe karrierës. Studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura të ciklit Bachelor në fillim të studimeve të tyre nënshkruajnë kontratën e cila përfshin periudhën e arsimimit dhe një periudhë shërbimi prej 6 (gjashtë) vitesh në Forcat e Armatosura. Studentët e ciklit Master orientohen dhe këshillohen nga stafi akademik që të aplikojnë në pozicionet vakante sipas profilit në strukturat e MM dhe SHPPA. Nga 51 studentë të diplomuar: – 40% janë punësuar në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. – 30% janë punësuar në sektorin privat të IT-së. – 30% janë të angazhuar në trajnime ose studime të avancuara. Ev-64-Studentet e diplomuar dhe integrimi i tyre në tregun e punës Ev-71-Pyetesor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, datat e provimeve apo datat e shlyerjeve të

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	detyrimeve, aksesohen gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të AFA. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohen edhe njoftime/informime të dobishme për programin e studimit, karrierë në forcat e armatosura. AN-4.11.2-Rregullore zhvillimi kurrikular mësimdhënies AN-4.12-Politika të vlerësimit akademik AN-4.13-Rregullore për testimet, provimet, procedurat e diplomimit AN-4.14-Diploma MP CS AN-4.14.1 Suplementi MP CS AN-4.15-Procedurë ankimimi për studentët AN-4.18-19-Politika e pranimit dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ u informua se sistemi Pitagora mundëson hyrje e dedikuar të studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion janë dhe faqet zyrtare të AFA ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve ndër të tjera mund të realizohet edhe nëpërmjet e-mailit. Ev-18-Shembuj të përdorimit të sistemit të brendshëm SHARE FOLDER			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon	Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos

dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe shërbimit për studentët. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit. Regjistrimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:

Master i Profesional në "Siguri Kibernetike"			
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2021-2022	15	-	15
2022-2023	19	-	19
2023-2024	23	-	23

Në Sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se Regjistri themeltar në momentin e vizitës, ishte i disponueshëm në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.

Ev-9-Tabelë me të dhënat Përmbledhëse

Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve

Ev-12-Të dhëna Tabelore për numrin e programeve

Ev-34-Raporti vjetor 2023-2024, AFA

Tabela me Anekset Master-Profesional Siguri Kibernetike

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nëpërmjet platformës Pitagora. Për të garantuar sigurinë e informacionit, hyrja realizohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar.

Institucioni mban të dhënat në mënyrë manuale në regjistra specifike, gjithashtu edhe në mënyrë elektronike. Këto të dhëna kontrollohen nga personat e autorizuar dhe ruhen sipas rregulloreve përkatëse në UBT.

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të

informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti, Sekretaria Mësimore dhe Sektori i statistikës disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe për punësimin e tyre.. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti, Fakulteti apo Akademisë. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik.			
	Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:			
	Master i Profesional në "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes"			
	Viti akademik	2021-2022	2022-2023	2023-2024
	Nota mesatare në hyrje	7.43	7.2	6.9
	Punësimi i studentëve tyre për periudhën 2021-2022 janë:			
	Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	
	13	7	6	
	Ev-12-Të dhëna Tabelore për numrin e programeve			
	Ev-34-Raporti vjetor 2023-2024, AFA			
Konkluzione	Tabela me Aneksat Master-Profesional Siguri Kibernetike			
	Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe shërbimit për studentët.			
	Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i AFA (neni 10 dhe 13), përcakton se studentët, në përputhje me aktet ligjore dhe ato rregullatore të AFA, janë të përfaqësuar në Senatin akademik, kanë përfaqësuesin e tyre në NJBSC, marrin pjesë në Këshillin e Etikës, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe organet kolegjiale sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC Ev-55-Rregullore e Këshillit Studentor Ev-56-Lista emërore e studentëve që marrin pjesë në këshillin studentor Ev-63-Lista e Studenteve që marrin pjesë në Organet Kolegjiale të AFA
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	AFA garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat (neni 10 i statutit), NJSBC, Këshillin e Etikës (neni 13 i statutit) dhe në të gjitha komisionet e organizuara në AFA si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB. Gjithashtu, studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura angazhohen në Këshillin Studentor të Akademisë së Forcave të Armatosura (KSAFA), si një organ kolegjial më i larti i përfaqësimit të studentëve brenda institucionit. Ky këshill ka edhe organin e vet informativ, revistën “Studenti Ushtarak”, ku pasqyrohen aktivitetet akademike, kulturore dhe sportive sikurse edhe aspekte të tjera të jetës studentore. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke mbajtur kontaktet me studentët dhe sugjerimet që studentët mund të kishin në raport me kurrikulën. Përveç sa më sipër, studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri si dhe në vlerësimin e praktikës mësimore nëpërmjet formularit përkatës.

	GVJ u informua mbi përpunimin e rezultateve të pyetësorëve dhe vënien në dispozicion si në Departament ashtu edhe drejtuesve njësisë kryesore dhe Institucionit. Rezultatet reflektohen edhe në raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC Ev-55-Rregullore e Këshillit Studentor Ev-31 Proces Verbal i Këshillit Studentor.pdf Ev-56-Lista emërore e studentëve që marrin pjesë në këshillin studentor Ev-63-Lista e Studenteve që marrin pjesë në Organet Kolegjiale të AFA Ev-71-Pyetesor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të institucionit (Senat, NJSBC, Këshillin e Etikës, GVB etj.). Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Ev-71-Pyetesor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Për sa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. GVJ, bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konkludon se studentët kanë të drejtën e rivlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirinformuar në këtë drejtim dhe se kishin patur raste të ballafaqimit me pedagogët për sa i përket vlerësimit, por që nuk kishin arritur deri në fazën e paraqitjes së ankimimit me shkrim. Nga takimi i GVJ me studentët, rezultoi që procedura realizohet në përputhje me rregulloren. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku bën pjesë

	studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. – Drejtuesi i FMS kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës, pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Drejtuesi i FMS një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i FMS vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. – Në rastin kur kërkesa refuzohet studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. – Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një Njësi tjetër Kryesore, Drejtuesi i Njësisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. – Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mbledhet komisioni ad-hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit/grupit mësimor dhe studentin. – Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit/grupit mësimor, nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. – Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëhere ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. Ev-71-Pyetesor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet			
Konkluzione	<i>AFA garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, Këshillin e Etikës dhe në të gjitha komisionet e organizuara në AFA si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), është njësi përgjegjëse për informimin e studentëve. Drejtori që ka në vartësi edhe Sektorin e Personelit dhe Përkujdesjes. Gjithashtu, si studentët aktual, ashtu edhe ata potencial mund të informohen edhe nga revista “Studenti Ushtarak”, një organ informativ i Këshillit Studentor të AFA AN-4.18-19-Politika e pranimi dhe regjistrimit të studentëve AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Ev-7-Plani Strategjik i Zhvillimit të AFA Ev-53-Urdher i MM për politikat dhe procedurat e rekrutimit të oficerëve të rinj Ev-69-Marrëveshje e Univeritetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), është njësi përgjegjëse për informimin e studentëve. Drejtori që ka në vartësi edhe Sektorin e Personelit dhe Përkujdesjes. Kjo drejtori harton çdo vit, planin vjetor të punës në mbështetje të informimin dhe këshillimin e studentëve. Gjithashtu, edhe të dhëna rreth mundësive të punësimit, si në njësi të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, ashtu edhe mundësi për punësim jashtë forcave të armatosura, sipas profilit të studimit. AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët https://www.afa.mil.al/images/pdf/4_Mundesipunesimi.pdf
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	DAK që është strukturë përgjegjëse që organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve, mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve. Institucioni harton edhe politika për mbështetjen dhe përkrahjen e studentëve, të cilat zbatohen nga të gjithë palët e përfshira. AN-4.20-Politika të mbështetjes dhe përkrahjes për studentët Ev-16-Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës https://www.afa.mil.al/images/pdf/4_Mundesipunesimi.pdf

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	DAK, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, synon edhe grumbullimin e informacionit që lidhet me të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe anketimi për gjurmimin e studenteve nga e cila është përmbledhur edhe informacioni i gjurmimit të punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program studimi. Ev-64-Studentet e diplomuar dhe integrimi i tyre në tregun e punës			
Konkluzione	GVJ konstatoi në AFA ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vet AFA-s.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Institucioni harton disa udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat përshtaten me nevojat specifike të fushave të studimeve dhe lëndëve/moduleve përkatëse. Këto udhëzues shërbejnë si një kornizë për stafin akademik, duke i orientuar ata drejt praktikave

mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	më të mira në mësimdhënie dhe duke mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. Ndër të tjera janë hartuar edhe plan veprimet për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përshtatja sipas fushës së studimit si dhe përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësise së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Njësitë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë është NJSBC, e cila ka rol vlerësues dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në AFA, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e Standardeve të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: – Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie; – Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit; Gjithashtu, duke qenë se AFA është në strukturën e Forcave të Armatosura, një vlerësim i shtuar është edhe monitorimi i veprimtarisë në kuadër të karakterit ushtarak të organeve drejtuese. Kjo formë rigoroze e monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe jo vetëm, vihej re edhe gjatë vizitës në institucion. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësise së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmeruar të stafit Akademik Ev-51-Pyetësor sondazh për bibliotekën nga studentët Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies,	Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe të ankimeve sanksionohet në rregulloren e institucionit dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë.

të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët janë të përfshirë në të gjithë strukturat vendimarrëse kolegjiale të AFA-s. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetsorëve. Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit në lidhje me temat e trajtuara dhe nëse ka nevojë për përmirësime. Kjo edhe për natyrën specifike të këtij programi, e cila kërkon një angazhim aktiv të studentit me stafin akademik. Ev-55-Rregullore e Këshillit Studentor Ev-56-Lista emërore e studentëve që marrin pjesë në këshillin studentor Ev-51-Pyetësor sondazh për bibliotekën nga studentët Ev-63-Lista e Studenteve që marrin pjesë në Organet Kolegjiale të AFA Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Sikurse edhe në kriterin më sipër, rezultatet e anketimit të studentëve bëhen publike fillimisht në departament. Pasi diskutohen në nivel departamenti, hartohet edhe raporti që pasi miratohet në njësinë bazë, përcillet në njësinë kryesore. Gjithashtu vlerësimi i stafit akademik bëhet edhe nga njësia bazë nëpërmjet formularit për vlerësimin e performancës. Raporti gjithashtu shqyrton edhe analizën mësimore kërkimore në nivel departamenti sikurse edhe në nivel fakulteti. Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet https://www.afa.mil.al/transparenca/41-programi-i-transparences
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Akademia e Forcave të Armatosura, ka në planet e saj, ndër të tjera edhe zhvillimin, trajnimit dhe kualifikimi e vazhdueshëm të stafit, si në aspektin e mësimdhënies ashtu edhe në aspektin e kërkimit shkencor. Stafi është i angazhuar në një sërë trajnimesh që janë edhe pjesë e aktiviteteve ushtarake me vendet e tjera anëtare të NATO-s. AFA ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit duke mundësuar edhe shkëmbinin e stafit akademik. AN-4.6-Dëshmi respektimit autonomisë, lirisë akademike financiare AN-4.7-Politika Burimeve Njerezore AN-4.7.2-Strategjia menaxhimit burimeve njerëzore AN-4.8-Politikia zhvillimit stafit akademik AN-4.8.1-Praktikë kandidimi kurse personeli

	AN-4.8.2-Trajnim stafit akademik FMS AN-4.10-Politika jashtme mobiliteti stafit studentëve Ev-14-Raporti mbi veprimtarinë Akademike dhe Kërkimore Shkencore			
Konkluzione	<i>AFA, organizon anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti dhe diskutohen në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masa për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar Statutit, në AFA, më konkretishti Kreut X të tij, institucioni përshkruan rolet dhe njësitë të cilat kanë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë, përfshirë këtu Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Gjithashtu institucioni ka hartuar dhe zbaton një sërë procedurash dhe rregulloresh të cilat kanë në fokus sigurimin e cilësisë. Njësitë kryesore të cilat janë përgjegjëse në nivel institucional për sigurimin e brendshëm të cilësisë, janë: – Senati Akademik; – Komisioni i Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës; – Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (DKSC) - o Sektori i Zhvillimit të Kurrikulës; - o Sektori i Cilësisë dhe Statistikave. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësisë së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion	Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmash në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave,

Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët. Funksionimi i sistemit të sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse. Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë njësi përfshihen personel akademik i brendshëm i universitetit si edhe studentë. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetësorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësisë së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Akademia e Forcave të Armatosura, është licencuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 28.10.1961 dhe ka marrë statusin e veçantë me VKM nr. 156, datë 19.02.2020 si Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) i vetëm në vend në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Akademia e Forcave të Armatosura, me njësitë kryesore të saj është akredituar institucionalisht në 04.04.2025 me vendimin nr. 63, të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite deri më 03.04.2030. NJSBC ka hartuar paketën e instrumenteve të cilësisë dhe GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me NJSBC evidentoi zhvillimin e anketimeve me studentët në trajtën e pyetësorëve dhe transmetimin e informacionit te drejtuesi i Departamentit. GVJ konstatoi se ka patur hartim raportesh të vlerësimit për programin e studimit shoqëruar me analizë, ku integrohen rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik në nivel departamenti si dhe është operuar me nxjerrjen e konkluzioneve të pasqyruar në raporte si dhe me plan aksioni për të adresuar problematikën e konstatuar. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC

	Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Bazuar në RVB, sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ, evidenton se në nivel institucioni, në nivel fakulteti si edhe në nivel departamenti kryhen analiza dhe raporte të përvitshme në lidhje me treguesit e performancës së stafit akademik por edhe ecurisë së programit të studimit. Synimi i këtyre analizave nuk është vetëm të evidentohen pikat e forta apo edhe mangësitë por qëllimi kryesor është të hartohen e ndërmerren plane veprimi për përmirësim. Një rol të rëndësishëm në sigurimin e të dhënave sidomos në lidhje me mësimdhënien dhe performancën e stafit akademik kanë edhe studentët e programit të studimit, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve online. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-34-Raporti vjetor 2023-2024, AFA Ev-45-Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri ose viti akademik			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmash në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit	Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme.

të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim Sektorit të Kurrikulave. Vlerësimi i pedagogëve në procesin e mësimdhënies realizohet çdo fund semestri të çdo viti akademik. Ky proces vlerësimi përbën një indikator apo kriter matës të cilësisë, etikës për procesin mësimdhënës. Formularët e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës që ai jep, mbledhen dhe përpunohen. Ato u raportohen fillimisht Rektorit dhe Zëvendësrektorit, më pas i vihen në dispozicion Dekanit të Fakultetit, të cilët ia referojnë në rrugë konfidenciale pedagogut përkatës. E gjithë kjo procedurë ka si qëllim final vlerësimin e gjendjes në të cilën bëhet vlerësimi, evidentimi i rasteve pozitive dhe jo pozitive, me qëllim që të merren masa për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve Ev-34-Raporti vjetor 2023-2024, AFA Ev-45-Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri ose viti akademik
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes koordinаторit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Informacionet e mbledhura nga këto instrumenta bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në Senat, me praninë e përfaqësuesve të studentëve, duke promovuar praktikën e mira dhe duke propozuar një plan masash për problematikat e evidentuara, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave të programeve të studimit të ofruara, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmirësimin e formave të vlerësimit të studentëve, etj. Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-11-Raport mbi verifikimin e kapaciteteve

lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Ev-34-Raporti vjetor 2023-2024, AFA Ev-45-Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri ose viti akademik Ev-51-Pyetësor sondazh për bibliotekën nga studentët Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	NJBSC, për kryerjen e vlerësimit përdor këto metoda të tërthorta: – Vrojtime në orët mësimore në auditor; – Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; – Rezultatet e arritura nga studentët në teste ndërmjetëse dhe teste finale, si edhe praktikant profesional; – Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, etj.); – Vrojtime gjatë kryerjes së praktikës; – Rezultatet e arritura të provimit përfundimtar të formimit; Metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit përfshijnë: – Takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, – Takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, – Takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, – Takimet me studentët ALUMI – Vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë mesimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve Ev-51-Pyetësor sondazh për bibliotekën nga studentët Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmëruar të stafit Akademik Ev-44-Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023 Ev-45-Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri ose viti akademik
Konkluzione	<i>Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme.</i>

	Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim Sektorit të Kurrikulave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Pjesë e aktive e AFA është edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, (Statuti i AFA, Kreu X). Sikurse cilësohet në Statutin e AFA dhe në rregulloren e NJSBC-së, neni 4, NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët, 3 (tre) personel akademik me kohë të plotë, përfaqësues i përzgjedhur nga secila njësi kryesore e AFA, 1 (një) anëtar i jashtëm, ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë i caktuar me vendim të SA, si dhe 1 (një) anëtar student, i caktuar nga Këshilli Studentor i AFA-së. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësisë së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-56-Lista emërore e studentëve që marrin pjesë në këshillin studentor Ev-63-Lista e Studenteve që marrin pjesë në Organet Kolegjiale të AFA
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren për sigurimin e cilësisë në AFA përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë e angazhuara në Sigurimin e Cilësisë, të tilla si Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, Këshilli i Studentëve, drejtuesi i institucioni, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë etj. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-4-Vendim i Senatit Akademik nr.86

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në rregulloren për sigurimin e cilësisë në AFA përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë e angazhuara në Sigurimin e Cilësisë, të tilla si Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, Këshilli i Studentëve, drejtuesi i institucioni, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë etj. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësisë së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmeruar të stafit Akademik Ev-51-Pyetësor sondazh për bibliotekën nga studentët Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se ngritja e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në rregulloren institucionale të sigurimit të cilësisë. Institucioni dëshmon që edhe në lirinë akademike të personelit, respekton integritetin dhe është jo diskriminues. Kjo vërehet edhe nga një paragraf i vendosur në Revistën Ushtarake, si botim i Forcave të Armatosura, ku tekstualisht thuhet: <i>[...The Academy of Armed Forces has academic freedom and abides by the legal obligations expressly defined in the law on Higher Education as well as all other legal acts that are mandatory for public institutions. The views and opinions expressed in the Military journal are those of the authors and do not reflect the official position of the Ministry of Defense, the General Staff of the Albanian Armed Forces, nor the Academy of the Armed Forces. The authors of the articles will not be subject to punishment for the free expression of their individual attitudes and positions, even if their content is not in accordance with the official positions of the defense institution. At the same time, the author/authors bear responsibility</i>

	<i>for distortions of facts as well as unreferenced copying of the writing and thoughts of other authors....]</i> Duke paraqitur në formë të shkruar se respekton integritetin akademik pa diskriminim. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësisë së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies Ev-3-Rregullore për Sigurimin e Cilësisë AFA 2023 Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmeruar të stafit Akademik Ev-51-Pyetësor sondazh për bibliotekën nga studentët Ev-71-Pyetësor Online për Vitin Akademik 2024 dhe Rezultatet			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni përfshin bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit ose ofrojnë ekspertizë të vlefshme për vlerësimin dhe përmirësimin e tij. Një vend të veçantë në këtë proces zë bashkëpunimi me Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë, e cila garanton përputhshmërinë e programit me nevojat e zhvillimit të vetë Forcave të Armatosura, por edhe më gjerë në fushën e sigurisë kibernetike.			
Konkluzione	<i>Ppersoneli akademik, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të Institucionit janë pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të	GVJ konstaton së dokumentat (Statuti i AFA, rregulloret dhe politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë) përshkruajnë politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi. Këto dokumenta

Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	janë vëne në dispozicion të GVJ, si dhe në kuadër të transparencës, rezultate të sigurimit të brendshëm të cilësisë publikohen edhe në faqen eeb institucionale. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparent dhe u komunikohen individualisht studenteve dhe të gjithë aktorëve në tjerë https://www.afa.mil.al/transparenca/41-programi-i-transparences
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara vëren që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm të cilat ruhen në arkivën institucionale në përputhje me normat e ligjit nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat” me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në Rregulloren e Njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë si dhe në përputhje me rregulloret e brendshme. https://www.afa.mil.al/revista-ushtarake
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Për përmirësimin e planit mesimor, departamenti propozon ndryshimet e nevojshme në programin e studimit apo në elementët përbërës të tij nisur nga nevojat e identifikuar për përmirësim, përpara fillimit të vitit akademik pasardhës. Në rast se nga njësia bazë, konstatohet nevoja për ndryshime në kredite në masën mbi 20% të përmbajtjes së programit të studimit të akredituar, ndryshimet e hartuara nga departamenti shqyrtohen në Dekanat, miratohen në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim ministrit përgjegjës për arsimin. Ndërsa, ndryshimet deri në masën 20 për qind, IAL mund t'i reflektojë në diplomën e lëshuar me miratim nga Senati Akademik dhe me njoftim në ministrinë përgjegjëse për arsimin. AN-4.11.1-Rregullore NJSBC

	AN-4.16-Procedurë për mbështetjen, zhvillimin, përmirësimi cilësisë së Prog. AN-4.17-Procedurë për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimi, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Informacionet e mbledhura nga këto instrumenta bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në Senat, me praninë e përfaqësuesve të studentëve, duke promovuar praktikën e mira dhe duke propozuar një plan masash për problematikat e evidentuara, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave të programeve të studimit të ofruara, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmirësimin e formave të vlerësimit të studentëve, etj. Ev-43-Raport mbi vëzhgimin e paparalajmeruar të stafit Akademik Ev-44-Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023 Ev-45-Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri ose viti akademik			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	AFA përfshin të gjitha organet e brendshme në trajnime periodike me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerezore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Gjithashtu personeli i AFA trajnohet në vazhdimësi si pjesë e Forcave të Armatosura, me pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga vendet anëtare të NATO. Në këtë kontekst, dhe referuar specifikave të këtij programi studimi, trajnimet e marra në kuadër të sigurisë kibernetike janë shumë të dobishme në rritjen e kapaciteteve të brendshme njerezore të institucionit.			
Konkluzione	<i>Institucioni paraqet Kulturë të Brendshme të Cilësisë mbi politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilat janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Siguri Kibernetike në fushën e mbrojtjes” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia e Forcave të Armatosura”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ka një traditë të konsoliduar në arsimin e lartë dhe është pozicionuar si një institucion me profil të qartë dhe unik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke tërhequr çdo vit interesin e një numri të madh maturantësh.
2. Programi studimi që përmbush nevojën aktuale të tregut të punës në tërësi, dhe ato të sigurisë kombëtare në veçanti, si pjesë e ekspertizës kombëtare në sigurinë kibernetike
3. AFA zbaton një politikë të hapur dhe gjithëpërfshirëse për punësimin dhe integrimin e stafit akademik dhe administrativ, duke përfshirë personel të kualifikuar nga radhët civile dhe ushtarake.
4. Ndërturje e kurrikulës akademike në një ambient ushtarak që paraqet zbatime konkrete dhe reale të sigurisë kibernetike
5. Punësim në nevojat dhe organikën e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë
6. Përdorimi i një baze laboratorike të azhurnuar, moderne dhe në përputhje me objektivat e të nxënies të këtij programi studimi

Pika të dobëta

1. Dokumentacione zyrtare si syllabuset, rregullorja e programit të studimit, rregullorja e AFA dhe suplementi i diplomës, kanë të dhëna që janë kontradiktore mes tyre për sa i përket mënyrës së vlerësimit (Standardi II.1, Kriteri 3; Standardi II.3, Kriteri 3; Standardi III.2, kriteri 1; Standardi V.2, Kriteri 3).
2. Mbështetje jo e mjaftueshme financiare për rritjen e aktiviteteve kërkimore-shkencore (Standardi II.6, Kriteri 4; Standardi III.1, Kriteri 3).
3. Personeli akademik, edhe pse me përvojë në fushën e sigurisë kibernetike, nuk është i gjithi me tituj dhe grada shkencore (Standardi I.2, Kriteri 1; Standardi IV.1, Kriteri 1 dhe 3).

Rekomandime

1. Të rishikohen rregulloret e brendshme e AFA, rregullore e programit të studimit si dhe suplementi i diplomës, që vlerësimi me nota të unifikohet.
2. Të rritet mbështetja financiare për kërkimin shkencor që ndikojnë edhe në rritjen e produkteve të kërkimit shkencor (botime, pjesëmarrje në konferenca etj.)
3. Të rritet angazhimi institucional në kualifikimin e stafit si dhe përthithjen e stafit akademik me tituj dhe grada shkencore.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master
"Cybersecurity in the Field of Defense" provided by the Higher Education Institution
"Armed Forces Academy"**

Strengths and affirmations

1. The Armed Forces Academy (AFA) has a consolidated tradition in higher education and has positioned itself as an institution with a clear and unique profile in the field of defense and security, attracting the interest of a large number of graduates every year.
2. Study program that meets the current needs of the labor market in general, and those of national security in particular, as part of the national expertise in cybersecurity
3. AFA implements an open and inclusive policy for the employment and integration of academic and administrative staff, including qualified personnel from civilian and military ranks.
4. Blending academic curriculum into a military environment that presents concrete and real-world applications of cybersecurity
5. Graduated students employed in the Armed Forces of the Republic of Albania
6. Use of an updated, modern laboratory base in accordance with the learning objectives of this study program

Weaknesses

1. Official documentation such as syllabuses, study program regulations, AFA regulations and diploma supplements contain contradictory data regarding the assessment method (*Standard III.2, criterion 1; Standard V.2, criterion 3, Standard II.1, criterion 3, Standard II.3, criterion 3*).
2. Insufficient financial support for increasing research and scientific activities (*Standard II.6, criterion 4; Standard III.1, criterion 3*).
3. Academic staff, although experienced in the field of cybersecurity, do not all have scientific titles and degrees (*Standard I.2, criterion 1; Standard IV.1, criteria 1 and 3*).

Recommendation

1. Review the internal regulations of the AFA, the regulations of the study program and the diploma supplement, so that the assessment with grades is unified.
2. Increase financial support for scientific research that also affects the growth of scientific research products (publications, participation in conferences, etc.)
3. Increase institutional commitment to staff training and the absorption of academic staff with scientific titles and degrees.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X